



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 20. 4. 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 20. 04. 2012. GODINE**

**PRILL – APRIL
2012**

E premte, më 20. 4. 2012

Drejton seancën kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Prezentë janë 75 deputetë.

Nëse jeni dakord ju shefat e grupeve parlamentare, dy pikat e para të rendit të ditës i kishim hequr sot nga rendi i ditës, pasi i kemi pasur dje- Deklarime jashtë rendit të ditës dhe pyetjet parlamentare.

A pajtoheni? Urdhëro, Visar!

VISAR YMERI: Kryetar, edhe në Kryesi kur jemi marrë vesh për këtë rend të dite ka qenë ky propozim edhe jemi marrë vesh në fund që t' i kemi këto dy pika që t'ua mundësojmë deputetëve që donë të deklarohen jashtë rendit të ditës edhe nëse kanë pyetje parlamentare, t' i shfrytëzojnë ato, tash unë s'po shoh arsye t' heqim tash, pse t' i heqim.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kryetari i Grupit, deputeti, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne jemi marrë vesh që të jetë në rend të ditës edhe ne mendojmë që të jetë në rend të ditës.

KRYETARI: Atëherë, le të mbetet në rend të ditës.

Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi. Deklarohuni, a jeni në emër të Grupit apo në emër të juaj personal?

HALIT KRASNIQI: Jo, në emrin tim personal.

Falemnderit, kryetar!

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë dhe të nderuara deputete,

Unë kam një shqetësim lokal dhe jo vetëm lokal, është me epiqendër në Malishevë, po që përfshinë: regjionin e Prizrenit, të Therandës, të Klinës, një pjesë të Drenasit dhe është shqetësim i parvjetshëm në këtë stinë, me përjashtim të vitit të kaluar që Qeveria ka pasur një qasje dhe një përkujdesje ku është ndarë një fond për zhdukjen e etheve hemorragjike dhe pasojave të tyre.

Me këtë rast tani dhe në këtë kohë për çdo vjet, 12 vjet pas luftës, ka pasur shqetësime të mëdha popullata e këtyre zonave dhe prej pasluftës deri në vitin e kaluar ka pasur 28 të vdekur, me përjashtim të vitit të kaluar që Qeveria pat intervenuar me një injeksion prej 40 mijë eurosh, ka pasur pak shqetësime dhe asnjë të vdekur. Kërkoj nga Qeveria që të

ketë përkujdesje edhe këtë vit dhe në këtë stinë dhe përnjëherë tani që të mos përsëriten shqetësimet e 12 vjetëve të tjera, por mundësisht të kalojmë sikur vitin e kaluar.

Unë për veten time kisha kërkuar nga Qeveria që të kërkojë një bashkëpunim edhe nga komunat përkatëse, këto që shtrihen në këto zona ku i prek ky shqetësim. Dhe, ethet hemorragjike, në mos të zhduken krejtësisht, të paktën të kalojnë me pasoja sa më të vogla. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka në emër të Grupit, deputeti Visar Ymeri!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Pavarësia nga Serbia duhet doemos të jetë edhe pavarësi ekonomike. Nuk mund të kemi pavarësi të mirëfilltë nëse e lejojmë Serbinë që në aspektin ekonomik të na mbajë të varur. Kjo gjë deri tash fatkeqësisht nuk ka ndodhur, dhe madje një pavarësi e tillë është luftuar me zell nga Qeveria e Kosovës.

E pavarësi ekonomike nuk mund të ketë në kushtet e varësisë energjetike. Informatat e fundit që janë publikuar në gazetën “Zëri” dhe që po debatohen gjithandej nëpër mediat e Tiranës, janë tejet brengosëse dhe, nëse janë të vërteta, të papranueshme. Interkonjeksionit 400 KW i Kosovës me Shqipërinë e mundëson pavarësimin energjetik të Kosovës nga Serbia, Por jo vetëm kaq, kjo linjë do ta mundësonte bashkëpunimin më të ngushtë energjetik mes Kosovës dhe Shqipërisë dhe do ta mundësonte komplementaritetin energjetik mes termo-energjisë së Kosovës dhe hidro-energjisë së Shqipërisë. Kështu do të reduktohej dukshëm mungesa e madhe e energjisë, të cilën e kemi të dyja vendet, por edhe do të ndërprehej varësia energjetike nga Serbia dhe kompanitë mafioze të saj në energji.

Ky është një projekt për të cilin është folur shumë, dhe rëndësinë e të cilit të gjithë, qofshin ekspertë të fushës apo laik në të e dinë dhe e njohin. Janë bërë gati dhjetë vjet që kur flitet për realizimin e këtij projekti, dhe ende jemi aty kemi filluar, pra jemi te fjalët. Deri tash e kemi ditur se ai nuk po ndërtohet, por vetëm kemi mundur të hamendësohemi për arsyet e mos ndërtimit të tij. Për shkak se sikur në Tiranë, ashtu edhe në Prishtinë, të gjithë krerët institucional vazhdimisht e pranonin se ky është një projekt tejet i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për të dyja vendet.

Serbia përfiton miliona euro në vit nga Kosova dhe Shqipëria, përmes eksportit të energjisë. Këto shuma parash të gatshme janë shumë të rëndësishme për ekonominë e Serbisë. Pra, është njëri prej aspekteve ku shqiptarët më së shumti e ndihmojnë Serbinë, dhe me këtë e dëmtojmë veten, sikur në rastin e Kosovës, duke blerë rrymë shumë të shtrenjta në kohën e kërkesës së rritur, dhe praktikisht duke i falur rrymë Serbisë, atëherë

kur e kemi atë të tepërt. Por jo vetëm kaq, po të ndërpritej importi i rrymës elektrike nga Serbia, atëherë rrjeti i Serbisë do të mbingarkohej dhe kështu Serbia do të gjendej në një pozitë të njëjtë me Kosovën ku do të detyrohej t'i jap rrymë falas Rumanisë dhe Bullgarisë, kur e ka të tepërt dhe sigurisht të blejë nga ata rrymë të shtrenjtë kur ka mungesë. Ashtu siç na e bën ne Serbia ne, sot do të mund t'ia bënim ne dhe të tjerët asaj nesër.

Kjo çështje është politike. Energjia përherë ka qenë dhe mbetet politikë. Dhe pengesat ndaj këtij projekti po shihet se janë politike. Ashtu sikur çintegrimi energjetik i Kosovës për së brendshmi është mundësuar nga kjo qeveri, ashtu edhe mos integrimi energjetik i Kosovës me Shqipërinë po pengohet nga këto qeveri.

Këto çështje duhen hetuar hollësisht, të gjenden fajtorët dhe të dënohen ata. Shqiptarëve sot u duhet pavarësia dhe bashkimi ashtu siç iu është dashur përherë. Për këtë duhet institucione të vullnetit dhe përgjegjësisë kombëtare, e jo institucione të biznesit dhe marrëveshjeve në dëm të qytetarëve dhe në dëm të kombit. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit!

Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Falemnderit, zoti kryetar!

Unë shpreh në emër të Grupit Parlamentar një shqetësim përkitazi me transmetuesin publik, RTK-në.

Konsiderojmë që nuk është korrekt gjatë transmetimit të drejtpërdrejtë dhe bën shkurtimin, gjegjësisht për mendimin tonë edhe censurimin e paraqitjes së disa deputetëve në raste të caktuara. Po e marr shembullin e djeshëm, edicioni i lajmeve të orës 11:00, që është i rregullt, nëse është i rregullt është i rregullt dhe duhet të jetë për të gjithë dhe ajo nuk është transmetuar në atë kohë, por në momentin kur e ka përfunduar fjalën kryeministri, 11:10, kur ka dal të replikojë, gjegjësisht ta thotë fjalën e vetë deputeti zoti Sabri Hamiti, është ndërprerë menjëherë dhe kanë hyrë lajmet. Konsiderojmë që veprimet e tilla janë të papërgjegjshme, sepse ose duhet të ketë trajtim të barabartë për të gjitha grupet parlamentare, për gjithë përfaqësuesit këtu, ose mos të transmetojnë fare seancën si të tillë, dhe kjo nuk është hera e parë që po ndodhë, por sot po e përsëris po e them ajo që ndodhi dje ishte shumë e freskët dhe ka reagime. Nuk është e drejtë në këtë mënyrë, sepse ky televizion është publik, dhe për publikun dhe financohet nga buxheti i Kosovës nga mjetet e qytetarëve tanë. Prandaj, trajtimi duhet të

jetë korrekt Prandaj, po e them edhe një herë, ne në këtë rast reagojmë publikisht për një veprim të tillë për mendimin tonë seleksionues, selektiv dhe cenzorues. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit!

Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Për të njëjtën çështje e kam kërkuar fjalën edhe unë. Nuk është hera e parë, ka ndodhur shumë shpesh, por dje ka qenë rast eklatant, e njëjta që ka ndodhur edhe me fjalën time, në kohën kur kam folur unë, ka qenë i ndërprerë transmetimi prej Kuvendit të Kosovës, pa asnjë arsye. Kjo na bënë të besojmë edhe më tepër se ka elemente në Radiotelevizionin e Kosovës që, jo vetëm që po e shndërrojnë prej transmetuesit publik, në transmetues shtetëror, por aq më tepër në transmetues partiak.

Mendojmë se kjo është një mënyrë për ta dëmtuar demokracinë në Kosovë, për ta dëmtuar Kosovën, për të dëmtuar gjithë atë që po mendojmë ta ndërtojmë bashkë dhe për të cilën e kanë plotë gojën edhe qeveritarët edhe njerëzit të cilët punojnë në Radiotelevizionin e Kosovës. Mendoj se është një moment i turpshëm për ta edhe për ne të gjithë, për të filluar në Kosovë në vitin 2012, thotë 20 e sa vjet pas rënies së komunizmit të na ndodhin këso ngjarje. Mendoj edhe një herë është goxha e turpshme edhe disa njerëz në RTK duhet të fillojnë t'ia vënë gishtin kokës. Falemnderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti, Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Falemnderit, zoti kryetar!

Kryeministër, kabinet,

Të nderuar deputetë,

Unë edhe dje pata ndërmend ta shfrytëzoj praninë e zonjës Tahiri këtu, po e shfrytëzoj rastin sot për një çështje që është mjaftë shqetësuese tani si regjion. Është fjala për taksën kufitare si rezultat i masave të reciprocitetit që është vendosur që nga dhjetori i vitit të kaluar, si rezultat i saj kemi shqetësime jashtëzakonisht të mëdha të gjithë banorëve të Preshevës, Bujanovcit dhe një numrit të madh të banorëve që janë të regjionit të Gjilanit të cilët kanë dy shtetësinë, për shkak të pengesave serioze në lëvizje. Po e them, po e shtroj këtë, e di që zëvendëskryeministri Kuçi ka pasur takime me përfaqësues, drejtues të këtyre komunave dhe një prej çështjeve të shtruar ka qenë kjo, janë dhënë edhe premtime publike e unë shpresoj që kjo do të tejkalohet sa më shpejtë, por ajo që po e shtroj unë këtu 80% e qarkullimit të veturave është ra prej kësaj kohe dhe po ashtu gjithë furnizimi i këtyre qytetarëve me materiale të ndryshme edhe me ushqimore dhe të tjera

tash nuk bëhet nga komuna e Gjilanit e komunave për rreth, po tregu është orientuar nga Maqedonia dhe po ashtu kemi lidhje familjare të ndryshme, pengesa të ndryshme. Edhe po ashtu ka edhe qytetarë që kanë dy shtetësinë e dëshirojnë të shkojnë të votojnë atje, është një kërkesë e ripërsëritur e këtyre qytetarëve që ne t'i kemi në konsideratë e ta shpejtojmë këtë proces në mënyrë që t'i heqim këto taksa ose t'i ulim sa më shumë që mundemi. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Luburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: I nderuar kryetar,

Dhe të nderuar deputetë,

Po ashtu edhe ne si Grup Parlamentar e shprehim brengën dhe shqetësimin tonë për Radiotelevizionin e Kosovës. Konsiderojmë se Radiotelevizioni i Kosovës nuk është tani një radiotelevizion publik, sidomos pas asaj si u transmetua Kuvendi, seanca e djeshme. Konsiderojmë që për së brendshmi ky televizion është privatizuar nga politika në pushtet. Por çështja që do të dua po ashtu ta ngre, është çështja e seancës së 6 prillit këtu në Kuvend dhe një gabimi që konsideroj që ka kaluar gjatë miratimit të ligjeve me rastin e miratimit të Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të punësuarve dhe punëkërkesve.

Mendoj se gabimisht dhe nuk është trajtuar drejt dhe ka kaluar një amendament i propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu, që konsideroj që prapë nuk ka qenë, mund të mos ketë qenë i qëllimshëm, për ndryshimin e nenit 2 dhe paragrafit 1.1 të këtij ligji, ku në evidencën e të papunëve, të papunësuarve dhe punëkërkesve, hiqen personat e moshës 15 deri në 18 vjeç. Këta persona sipas argumentimit thuhet se janë sipas konventës ndërkombëtare këta trajtohen si fëmijë, dakord kjo është shumë e vërtetë, këta trajtohen si fëmijë, por mos të harrojmë që sipas Ligjit të punës këta persona kanë të drejtë pune dhe me që kanë të drejtë pune këta janë potencialisht punëkërkes. Duke qenë potencialisht punëkërkes këta duhet të jenë në evidencë për shkak se nëse nuk i mbajmë në evidencë këta mund të shfaqen në tregun e zi të punës. Pikërisht pse janë të mitur ata duhet të jenë në evidencë, sepse duhet të monitorohet trajtimi i tyre duke qenë shumë të vetëdijshëm që ata mund të abuzohen dhe mund të punësohen diku dhe të keqpërdoren. Pra, sipas ligjit ata kanë të drejtë në punë të lehta dhe në punë me orar të shkurtuar, ndërsa nëse nuk i mbajmë në evidencë, atëherë shumë thjesht ata do të mund të bëhen prej abuzimeve.

Çështja tjetër është që, këta fëmijë do të duhej të qëndronin në evidencë edhe për një fakt tjetër që shteti do të mund të organizonte, të ketë plane konkrete për ta, të organizojë trajnime për ta, të organizojë mënyrën se si ata do të mund të punësoheshin nëse nuk

janë në shkollë, sepse ka të tillë meqë shkollimi i mesëm nuk është obligueshëm ata persona janë punëkërkues potencial, sepse nuk janë në shkollë, ndërsa ka edhe të tjerë të cilët janë në shkollim të mesëm në drejtime teknike dhe e kanë të obliguar punën praktike. Dhe në këtë rast, pikërisht këta persona, këta fëmijë do të duhej të ishin të monitoruar dhe të kontrolluar, dhe një gjë e tillë do të mundësohej duke qenë në evidencë. Nëse, konsiderojmë se pjesëmarrja e tyre në evidencë do ta rriste papunësinë duhet ta kemi të qartë që sotuerët sot janë të tilla që shumë thjeshtë, t'i mund të japësh shifrat e papunësisë duke mos i përfshirë ata dhe duke i përfshirë ata. Pra, shumë thjeshtë shifrat e papunësisë mund t'i jepen nga mosha 18 ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Jo, faleminderit! Pse realisht kemi debatuar dhe kemi votuar për këtë çështje. Kjo ka qenë në rend të ditës, i nderuari deputet, po nuk është mirë të trajtohet jashtë rendit të ditës.

Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj – Beqaj.

RITA HAJZERAJ – BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë dua ta shpreh një shqetësim të nxënësve të Shkollës fillore "Bajram Curri" në Istog. Zoti ministër i Arsimit e di shumë mirë që para tri vjetëve ka filluar të ndërtohet kjo shkollë, po për çudi punimet në këtë shkollë janë ndaluar dhe nuk e dimë ende pse. Komuna e Istogut duke e parë se mësimi nuk mund të ndalohet për tri vjet, ka bërë një renovim të një shkolle të vjetër që nxënësit aty po e vijojnë shkollën dhe çdo ditë jeta e tyre është në rrezik. Andaj, unë kërkoj nga ministri që të marrë masa dhe të shohë se për çka janë ndërprerë ato punime dhe jeta e këtyre nxënësve të jetë më e mirë dhe të startojnë, të fillojnë në shkollën e re për të cilën është zotuar Ministria e Arsimit. Falemnderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pasi të kryhen deklaratimet e deputetëve, ministrat kanë të drejtë të deklarohen, nëse kanë për të thënë diçka.

Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Falemnderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Sot 3 minutshin tim do t'ia shfrytëzoj ambasadores më të mirë të Kosovës dhe imazhit të vërtetë në botë.

Sukseset e saj po na bëjnë të gjithëve krenarë dhe s'kam dyshim se ajo është një inspirim për shumë të rinj të Kosovës e fjala është për të vetmin emër në Kosovë, Majlinda Kelmendi.

E dinë të gjithë, në të kaluarën Majlinda është përballur me shumë sfida për shkak të mungesës së mbështetjes institucionale dhe shpesh është tunduar nga oferta milionëshe për të përfaqësuar flamuj dhe shtete tjera, por dua ta quaj me fat Majlindën dhe sportin në përgjithësi që në krye të Ministrisë së Kulturës, kemi një ministër i cili qysh në ditët e para ka garantuar mbështetjen institucionale, madje edhe atë të sektorit privat për sportisten tonë më të suksesshme. E ndjej për obligim që si deputete dhe si qytetare e Kosovës të falënderoj thellësisht ministrin Memli Krasniqi, për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë Majlinda Kelmendit dhe për vlerësimin e lartë që i ka bërë Majlindës, duke shpërblyer për sukseset e arritura deri më tash. Po ashtu është jashtëzakonisht inkurajues edhe përkushtimi i madh i ministrit Krasniqi që Majlinda Kelmendi të luftojë për medalje në lojërat Olimpike “Lodra” 2012. Fakti që në Parlamentin Evropian, Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe me shumë mekanizma tjerë ndërkombëtarë, politikë e sportiv shqyrtohet me shumë seriozitet çështja e Majlinda Kelmendit dhe pjesëmarrja e saj në lojnat Olimpike “Lodra” 2012, tregon për angazhimin e madh institucional në këtë drejtim.

Pranimi i Federatës së Xhudos së Kosovës në Federatën Ndërkombëtare të Xhudos me të drejtat e plota, është edhe një sukses tjetër i ndërkombëtarizimit të sportit kosovar i cili u arrit me angazhimin e ministrit Memli Krasniqi.

Dua të theksoj po ashtu se jo vetëm rasti i Majlinda Kelmendit, por sporti në përgjithësi tashmë ka një trajtim shumë më të mirë dhe shumë më serioz. Natyrisht që mbesin edhe shumë sfida në këtë fushë, por me një bashkëpunim të gjithë faktorëve relevantë, sukseset do të jenë edhe më të mëdha. Duke ju uruar shumë sukses Majlindës nga këtu sot i them se gjithë rinia e Kosovës është e nderuar dhe krenare me ju.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Dua ta ngre një shqetësim të qytetarëve që kanë të bëjnë me komunën e Ferizajt, komunën e Shtimes, komunën e Lipjanit dhe komunën e Fushë Kosovës, po barra më e madhe i bie Lipjanit. Fjala është për rregullimin e shtratit Sitnica.

Vërshimet, pranverë –vjeshtë, jam thellë i bindur që dëmet i shkaktojnë më shumë se investimi që do të ndodhte. Kam parasysh se shumë fshatra në atë regjion nuk kanë kanalizime as nuk kanë ujësjellës dhe vërshimet e tilla sjellin edhe pasoja shëndetësore të rënda. Mendoj se është koha e fundit që Ministria e Bujqësisë, sepse humbin miliona aty, Ministria e Ambientit ta marrin këtë çështje në konsiderim dhe të bëjnë një zgjidhje adekuate për ata njerëz. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit, deputet!

Fjalën e ka deputetja Sala Berisha – Shala.

SALA BERISHA – SHALA: Falemnderit, kryetar!

Përshëndetje kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Nëse vërtet RTK-ja ka bërë një sjellje të tillë ndaj, e ka ndërprerë transmetimin, shqetësimin që e paraqitën këtu tre deputetët tanë, unë mendoj që kjo nuk është e mirë, sepse misioni i RTK-së është që ta informojë opinionin publik. Mirëpo, këtu u pa shqetësimi i tre deputetëve burra dhe ju sugjeroj këtyre le ta ndjekin shembullin e motrave kallabllak të grave dhe le ta bojkotojnë RTK-në sikurse gratë që e bojkotuan Klanin. Falemnderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Falemnderit, zotni kryetar,

Zotni kryeministër,

Unë dje kam folur për tri pika, e shfrytëzoj rastin tash e përsëris në këtë kohë timen të deputetëve, që është problem dhe jo kulturë politike që njerëzit, përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, duke filluar nga ky Kuvend që ka deputetë që përfaqësojnë vullnete, ta bëjnë referencë raportin me Serbinë për ndodhitë në Kosovë.

Kjo më jep të drejtë edhe një herë ta theksoj, sepse u përpoqa ta theksoj dje, në vend se të reflektohet për këtë problem, shkoi deri në absurd ky diskutim. Kam qejf RTK-ja në daç lë ta ndërpresë, në daç jo, nëse donë le ta lëshojnë sot meqë e kanë ndërpre dje.

Dhe, është shumë qesharake të ndërprehen fjalët e deputetëve duke pasur parasysh qëndrim politik.

Këtu është mëkati i RTK-ës, nuk është puna a e kanë ndërpre lajmet. Problemi është që marrin guximin të bëjnë trajtime politike të të folurit në Parlament.

Ky nuk është problem që po e ngris veç për Parlament. Ky është problem i shoqërisë të Kosovës. Kjo shoqëri politike dhe e organizuar, kurrë nuk do të bëhet e aftë të zgjidhë problemet e veta, të bëjë zgjidhje të brendshme autentike përderisa sjelljet e saj mund të derivojnë në bazë të raporteve, mbështetjeve, opinioneve të një vendi jashtë këtuhi. Falemnderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër, ministra, deputetë,

Unë nuk e kisha në plan të marrë fjalën, mirëpo u provokova nga prononcimet edhe denoncimet që i bënë RTK-së në këtë mënyrë nga interesat puro- personale dhe desha ta asocioj diçka që nuk flitet për televizione tjera private dhe që interesi i disave që të krijohet perceptimi për televizione tjera. Mbrëmë, për shembull në një televizion privat e pash në mënyrë paragjyquese, paragjykoj zgjedhjet në Ferizaj, do të fitohen nga Partia Demokratike, mënyrë hipotetike nga disa analistë të cilët i japin të drejtë dhe kjo ju shkon përshtati, normalisht opozitës. Mirëpo, sot nëse flitet për RTK-n është interesi që të fuqizohen disa televizione të cilat kanë interesa puro materiale dhe humbin kuptimin e informimit neutral publik. RTK-ja ka problemet e veta, është e vërtetë qysh në planin edhe redaksional edhe të tjera, mirëpo nuk është mirë që të qitet në tapetë një televizion sikurse që ka ndodhur edhe në Shqipëri me Televizionin Shqiptar, i cili sot nuk shihet, sepse mënyra e tillë e atyre që e financojnë në mënyrë private janë bosët e mafisë ekonomike mediatike dhe sot Televizioni Shqiptar është “mbet” dhe nuk e sheh askush. Falemnderit!

KRYETARI: Nuk është mirë realisht të nxiten deputetët, mua po më vjen keq, deputetët lë ta shfrytëzojnë të drejtën e vetë dhe kohën e vetë, por nxitja nga diskutimi nuk sjell interesin e publikut.

Megjithatë, unë fjalën po ja japë deputetes Alma Lama.

ALMA LAMA: Falemnderit, zoti kryetar!

Unë thjesht dua të shpreh keqardhjen time të thellë që ende këtu në Kuvendin e Kosovës ka deputetë të cilët madje mund të kenë më shumë se sa një mandat, që ende nuk e dinë se cili është misioni i televizionit publik. Ju rekomandoj ta lexojnë Ligjin për RTK-n, për ta mësuar, të cilin madje sa po e kemi miratuar.

Së dyti është me të vërtetë për të ardhur keq që edhe këtu në Kuvend ka deputetë që i pasurojnë argumentet e tyre me gjuhë dhe këngë mahallash, është tepër e ulët të shërbehesh me këtë nivel të gjuhës. Falemnderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja, Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Falemnderit, kryetar!

Unë e mora fjalën për t'ju thënë ju zoti kryetar ashtu sikurse u banalizua seanca e djeshme edhe e pardjeshme nga zoti kryeministër, ashtu edhe kjo pikë e rendit të ditës po shfrytëzohet nga shumë deputetë, duke u ra ndërmend diçka për të ngritur një çështje, me të vërtetë po banalizohet vetë kjo pikë që është shumë me rëndësi për të ngritur një çështje me interes të popullit. Prandaj, edhe një herë po dua ta bëj një sugjerim që mos ndodhë edhe mos t'i jepet fjala gjithkujt ose mos të nxiten në fakt për të thënë hiq gjë në këtë pikë shumë të rëndësishme. Mua më vjen keq që dikujt i bie ndërmend tash e merr fjalën edhe nuk thotë asgjë, vetëm për të humbur kohë. Edhe çka është më e keqja, nuk është interes për të dalë apo mos me dalë në media, por është në interes ta thuash ta dish çka po thua, ama nuk po thuhet kurrgjë e kështu po kërkojnë për me qenë në media, por dua dimë çka po themi kur jemi në media, mos të jemi fare në media, por të bëjmë diçka për popullin.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetët po e marrin fjalën.

Fjalën e ka deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Unë në diskutimin tim të shkurtër po mundohem që t'ju shtjelloj disa gjëra dhe ndër to kryesoret është terrorizimi i shoqërisë kosovare nëpërmjet deklarimeve publike që e bëjnë, sidomos kryeministri duke shantazhuar edhe kërcënuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, se këta e paskan takuar dikë në konferenca ndërkombëtare apo paskan bërë veprime të ndryshme. Që realisht ju e dini si ndodh në konferencat ndërkombëtare, e dini se çfarë lloj takimesh mund të ketë aty dhe unë jam i bindur që deputetët të cilëve iu ka

referuar zotëria në fjalë, as nuk ka pasur takime personale dhe as nuk kanë ndejtë për të ngrenë dreka, darka me ta, as për të fjetur.

Kështu që këto diskutime po ulin nivelin e debatimit dhe po ulin nivelin e diskutimit të interesit të qytetarëve të Kosovës dhe mbrojtjes së interesit të tyre. Prandaj do të ishte mirë që këto lloj diskutimesh të mos bëhen dhe të mos kemi nevojë, sepse ne parimisht duhet të dimë se edhe kryeministri nëse takohet ose dikush tjetër e ka prioritet kryesor mbrojtjen e interesit të Kosovës. Mirëpo, në raste të caktuara kryeministri si përfaqësues i popullit të Kosovës, duhet të ketë parasysh disa elemente. Takimet të cilat mbahen nga ai dhe përfaqësuesit e Qeverisë, duhet të jenë takime të cilat, të jenë edhe publike, po të jenë edhe transparente dhe Kuvendi të informohet, sepse kemi miratuar edhe rezoluta për këtë punë.

Tragjedia më e madhe në kuptimin e kësaj pune është kur kësaj pjese i bashkëngjitet edhe një institucion publik si Radiotelevizioni i Kosovës dhe i hyn valles për censuruar dhe për të ndërprerë diskutime publike të cilët bëjnë deputetët të pozitës apo të opozitës qofshin këta.

Unë mendoj se po hyjmë në një situatë ku nuk është në interes të qytetarëve të Kosovës dhe nuk është në interes të Kosovës të diskutohen tema, sepse unë kam prirjen personale të besoj se asnjë prej deputetëve të Kosovës dhe as vetë kryeministri dhe ministrat e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nuk punojnë kundër interesit të Kosovës dhe në ato takime nuk marrin vendime që janë kundër interesit të Kosovës. Prandaj, të mos bëjmë kësilloj diskutimesh që dëmtojmë edhe imazhin tonë, por edhe imazhin e Kosovës, por edhe besimin e qytetarëve të Kosovës te institucionet e Kosovës, sepse hedhja e topit në këtë formë po dëmton besueshmërinë e qytetarëve të Kosovës, te institucionet e Kosovës dhe kjo është e papranueshme, e papranueshme në koncept po edhe e papranueshme në realitetin të cilin ne jetojmë. Nëse ka pasur takime të kryeministrit me Tadiqin, le të thotë që e ka takuar, le të tregojë pse e ka takuar dhe rezultatin e tyre, nuk ka kurrëgjë të keqe, ai është kryeministër dhe mund të përfaqësojë Kosovën jashtë. Kryeministri i një shteti të pavarur takon presidentin e një shteti tjetër të pavarur edhe pse kemi marrëdhënie jonormale, për mos me thënë marrëdhënie armiqësore. Deputetët, në qoftë se kanë marrë pjesë në konferenca ku ka përfaqësues edhe të Qeverisë ose të institucioneve të Serbisë, çka ka të keqe, ata, distanca në konferenca mund të jetë edhe fizike është edhe konceptuale? Prandaj, degjenerimi i debatit ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Falemnderit!

Të nderuar deputetë,

Realisht, kjo pikë e rendit të ditës është harxhuar për sot. Kryeministër e keni të drejtën më vonë. Unë dua t'i sqaroj deputetët nëse vërtetë doni të bëni debat, ia ndryshojmë karakterin kësaj pike të rendit të ditës dhe para çdo seance bëjmë një orë debat dhe pastaj sipas grupeve e marrin fjalën deputetët dhe e bëjmë debatin me replika dhe kundër replika. Por, kjo pikë e rendit të ditës është për të ngritur çështjet që janë në interes të publikut dhe mund t'ju them që në këtë rrafsh vetëm dy deputetë e kanë shfrytëzuar këtë të drejtë, gjithë të tjerët kanë qenë nxitje e debatit. Tash unë fjalën ia jap, Qeveria e ka të drejtën e deklarimeve, edhe kjo jashtë rendit të ditës.

Fjalën e ka kryeministri, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Unë do t'ju ftoj të gjithëve, gjithë deputetët e të gjitha partive politike që në këtë seancë, që mund të themi që do të duhej ta kishte edhe një lloj karakteri edhe solemn për shkak të agjendës që kemi, të jetë një seancë që t'i tejkalojmë secili interesat partiake apo edhe individuale apo edhe grupe.

Shoh përpyetje për të rikthyer tema që mendoj që nuk i kontribuojnë agjendës së ardhshme, konsolidimit dhe forcimit të shtetit tonë, por pasi që po hapen gjithmonë çështje që me të vërtetë ndonjëherë edhe krijojnë rrethana jo të favorshme diskutimi në Parlamentin e Kosovës, unë mendoj që të vazhdojmë dhe ju ftoj të gjithëve me agjendën që e kemi të planifikuar dhe pastaj në një rrethanë më të përshtatshme zhvillojmë një debat të veçantë për marrëdhëniet e Kosovës me Serbinë, ku edhe unë do të jem, edhe Qeveria edhe ju dhe diskutojmë nëse doni prej 1912 e tutje deri sot. Falemnderit, shumë!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar ministri, Besim Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Falemnderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Për hir të mirë informimit të publikut dëshiroj të theksoj se projektet energjetike dhe në veçanti autostrada energjetike e cila është duke u përgatitur që të fillojë punën, është një projekt nacional, projekt të cilën Qeveria e Kosovës e ka me çështje profesionale të trajtuar dhe po e trajton në mënyrë profesionale, nuk është kjo çështje për tema dhe

debate politike e aq më pak për sjelljen e debateve politike të Shqipërisë në Kuvendin e Kosovës. Ne jemi të përcaktuar dhe jemi duke punuar në përditshmëri që kjo autostrada energjetike dhe integrimi energjetik në mes të Kosovës dhe Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit të ndodhë sa më shpejtë për mirë të furnizimit energjetik të qytetarëve të Republikës së Kosovës, por nuk do të ishte e rregullt dhe nuk do të ishte për çështje të agjendave politike, të sjellin agjenda të cilat janë atje politike, të sjellin në Kuvendin e Kosovës dhe të bëhen politike. Falemnderit!

KRYETARI: Visar, dy minuta.

VISAR YMERI: Falemnderit, kryetar!

Pra, kjo çështje siç e përmenda unë në fjalën time fillestare nuk është që sot, është një kohë goxha e gjatë që kjo çështje nuk po rregullohet dhe nuk po ndërtohet, nuk ka filluar as nga ana e Kosovës as nga ana e Shqipërisë. Pra, këtu pyetja shumë e thjeshtë është, pse nuk e keni bërë pra në Qeverinë e Bajram Rexhepit 2002 -2004 kur e keni pasur pushtetin, pse nuk u bë prej vitit 2007 që e keni pushtetin si Qeveri, pse nuk po bëhet edhe në këtë mandat? Pra, mos më thuaj që do ta bëjmë, nuk është këtu çështje do ta bëjmë se e kemi humbur që 10 vjet që nuk e keni bërë.

Edhe tjetra është që, thjesht ju natyrisht nuk keni interes për integrim me Shqipërinë, sepse jeni avancuar në karrierë edhe jeni pasuruar duke mbetur kështu të ndarë si Kosovë nga Shqipëria dhe këtë e dinë të gjithë, edhe nuk e keni as kredibilitetin minimal për të folur për këtë çështje, sepse ju jeni ata që e keni nxitur, deputetët e juaj për me prua një kundër mocion, kundër mocionin për reciprocitet me Serbinë. Pra ju jeni ata që i keni detyruar deputetët e juaj ta votojnë një mocion, i cili i garanton edhe ia përjetëson nënshtrimin politik edhe ekonomik të Kosovës ndaj Serbisë, pra këtë e dinë të gjithë edhe mos mu shit ashtu si kishe nuk po din dhe si kishe jeni duke punuar për diçka.

Po çështja tjetër është që, çka keni bërë ju për çështjen e uzurpimit të rrjetit energjetik në veri nga Serbia, prej se jeni në pushtet? Nuk keni bërë asgjë.

Tjetër, cila do të jetë marrëveshja për energjinë në veri, si po shkojnë negociatat me Serbinë edhe e dimë që njëra prej temave që është diskutuar edhe do të diskutohet aty, do të jetë pikërisht për këtë. Pra, nëse krijohet atje siç është përfolur se do të krijohet dhe sigurisht që do ta pranoni që do të krijohet një kompani e ndarë aty për veriun, atëherë a nuk është ky çintegrim energjetik i Kosovës, që e thashë në fjalën time ndaj të cilës po reagon? Dhe, çështja tjetër është që ka informata edhe këto janë bërë publike që Qeveria e Shqipërisë ka qenë e interesuar që ta bashkëfinancojë Termocentralin e Kosovës,

Termocentralin e Ri të Kosovës, në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, ju e keni penguar atë dhe ju e keni refuzuar atë.

KRYETARI: Urdhëro, ministër përgjigju.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Mua më vjen keq që në Kuvendin e Republikës së Kosovës, deputet Ymeri, shfrytëzohesh me shpifje, të cilat janë të nivelit më të ulët të mundshëm, me shpifje të cilat si duket iu ka mbetur merak për të dhënë kontribut më herët edhe në bazë institucionale. Të flasësh për gjëra të cilat nuk i dini dhe për gjëra të cilat nuk jeni kompetent dhe për gjëra të cilat nuk i keni përcjell asnjëherë me interes kombëtar, por me interesa krejt vetanake për shfrytëzim të momenteve të rëndësishme politike për dezorientim të agjendës politike të shtetit të Kosovës, kjo është tepër e ulët, prandaj, unë nuk dua të hy në bisedë me çështje të shpifjeve. Falemnderit!

KRYETARI: Fjalën e ka ministri Rexhepi.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Unë dola vetëm ta bëj një sqarim se s'kanë informatë se Interkonjeksioni 400 KW ka filluar fizibilitetin në kohën kur kam qenë kryeministër dhe ka qenë një ndër prioritetet kryesore. Në Bankën Botërore atëherë me zotin Kristijan Portman, për shkak të senzibilitetit politik kanë propozuar 2 – 3 alternativa, njëra ka qenë nëpërmjet Malit të Zi, tjetra nëpërmjet Maqedonisë dhe 2 – 3 forma të tjera edhe kompromisi ka qenë që KEK-u dhe KESH-i do të vendosin cili model do të shkojë. Kjo ka qenë marrëveshja atëherë dhe fizibilitetit ka qenë i gatshëm të investojë dhe të them se gjeneza e asaj ka filluar prej atëherë, po s'i keni informatat e mira dhe implementimi kanë qenë çështja e financimit dhe sendet tjera.

KRYETARI: Falemnderit!

Fillojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës ka kaluar. Vazhdojmë.

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45.1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta, deputeti për një mbledhje mund të parashtojë më së shumti dy pyetje parlamentare.

Fillojmë me pyetjen e parë, deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Ferid Agani, ministri nuk është këtu.

Deputete, e doni fjalën.

Regjia fjalën deputetes Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Falemnderit, zoti kryetar!

Me qenë se ministri i Shëndetësisë nuk është as sot ndoshta ka ndonjë përgjigje kryeministri. Kryeministër, kohë më parë nga Ministria e Shëndetësisë është marrë një vendim krejtësisht me bindje fetare në institucionet shëndetësore siç janë institucionet profesionale. Me këtë rast është bërë edhe shkelja e Kushtetutës, sepse ne me Kushtetutë jemi shtet laik dhe si keni lejuar të merret një vendim i tillë?

KRYETARI: Falemnderit, deputete!

Ministri nuk është këtu.

Fjalën e ka zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, do të përgjigjet për këtë çështje.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Falemnderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete,

Unë dua të them që vendimi i tillë nuk është shqyrtuar në Qeveri asnjëherë, ministri e ka marrë, do ta shohim formën ligjore dhe kushtetuese. Po e them paraprakisht që Kosova është shtet laik, në kuptimin e kësaj institucionet publike nuk mund të kenë premisa fetare.

KRYETARI: Vazhdojmë. A ke pyetje shtesë, deputete?

Fjala deputetes Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Zoti zëvendëskryeministër,

Kur do të jetë kjo përgjigje, sepse një vendim i tillë është i rregulluar me disa dokumente ligjore që posedon Ministria e Shëndetësisë është Karta e të drejtave të pacientëve, një prej të drejtave të pacientëve është edhe e drejta ta zgjedhë mjekun dhe ky vendim i ministrit Agani është një vendim absurd edhe krejtësisht fetar po mendoj. Falemnderit!

KRYETARI: Unë mendoj që përgjigja e zëvendëskryeministrit ishte që Qeveria s'është në dijeni dhe sigurisht që Qeveria edhe ministri e dinë se gjithçka që bie ndesh me Kushtetutën, duhet të shfuqizohet.

Vazhdojmë me pyetjen e dytë, deputetja Blerta Deliu, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi.

BLERTA DELIU: Zoti ministër,

Më datën 5 prill të këtij muaji janë përkujtuar viktimat e masakrës së Rezallës, që është masakra e dytë për nga numri i viktimave në komunën e Skenderajt dhe masakra e parë për nga numri i trupave të pagjetur dhe të paidentifikuar. Çfarë po bën Ministria e Drejtësisë për fatin e të pagjeturve?

KRYETARI: Zëvendëskryeministër e ke fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

E nderuara deputete,

Sa i përket rastit të masakrave dhe gjenocidit që ka ndodhur kudo në Kosovë po edhe në fshatin Rezallë, akoma janë të zhdukur rreth 37 persona ku edhe përkundër përpjekjeve të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës së pasluftës nuk është gjetur asnjë shenjë se ku mund të ndodhin këta persona të cilët janë të zhdukur nga forcat policore, ushtarake dhe paraushtarake serbe.

Në Rezallë janë zhdukur edhe disa persona nga fshati Marinë dhe Llozicë për të cilët po ashtu akoma nuk kam ndonjë informacion për vendndodhjen e tyre.

Për gjithë këta persona të pagjetur, por edhe persona të tjerë të zhdukur, dyshohet se gjenden në Serbi. Andaj me qëllim të zbardhjes së fatit të pagjeturve, Qeveria e Kosovës në vazhdimësi është duke bërë trysmi të vazhdueshme përmes bashkësisë ndërkombëtare për zbardhjen e fatit të pagjeturve.

Të vetëdijshëm për kompleksitetin dhe politizimin e skajshëm të kësaj çështje, janë intensifikuar takimet në mes të Komisionit Qeveritar për të Pagjeturit dhe Grupit punues për këtë çështje, me përfaqësuesit e Serbisë, me qëllim të gjetjes së personave të zhdukur.

U shpreh përkushtimi në emër të Qeverisë së Kosovës, për zbardhjen e fatit të tyre me çfarëdo angazhimi politik dhe ndërkombëtar, në të gjitha nivelet e takimeve dhe kjo çështje është ngritur dhe do të kërkojmë që me fuqi të zbardhet fati i tyre te autoritetet serbe përmes ndikimit ndërkombëtar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputete a ke pyetje shtesë?

BLERTA DELIU: Zoti ministër,

Viti 2012 është përcaktuar edhe si vit strategjik për hulumtimin dhe zbulimin e personave të pagjetur. Grupet punuese për persona të pagjetur kanë paralajmëruar hapjen e 36 lokacioneve ku dyshohet se mund të ketë trupa të pagjetë të shqiptarëve të vrarë gjatë luftës së fundit. Sa lenë shpresë kjo se do të ketë diçka të re për familjarët që i kanë të zhdukur anëtarët e tyre?

KRYETARI: A ke përgjigje, zëvendëskryeministër.

HAJREDIN KUÇI: Angazhimi ynë është permanent, natyrisht që nuk është në dorën tonë drejtpërdrejt. Dyshohet se do trupa janë në Serbi dhe politika e Serbisë, Qeveria e Serbisë e din këtë çështje. Natyrisht kemi kërkuar edhe përmes kontakteve ndërkombëtare, përfshirë edhe dialogun me Serbinë që të hyjë kjo çështje, ku e kemi theksuar me një platformë të veçantë.

Ajo çka mund të themi ne, do t'i kryejmë të gjitha obligimet tona si shtet dhe si Qeveri.

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër!

Radha është për pyetjen e tretë.

Deputetja Donika Kadaj – Bujupi, pyetje për zëvendëskryeminstriin Hajredin Kuçi.
Deputete e ke fjalën.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Faleminderit!

I nderuar kryetar!

Pyetja ime lidhet me Rezolutën e 28 korrikut të aprovuar nga ky Kuvend, pika e parë dhe pika e pestë e së cilës obligon dhe kërkon nga Qeveria angazhimin e saj për vendosjen e autoritetit kushtetues në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Prej atëherë përveç aspekteve deklarative ne nuk kemi parë veprime konkrete të ndërmarra nga Qeveria, prandaj e pyes zëvendëskryeminstriin- derisa veriu i vendit vazhdon të mbetet jashtë juridiksionit të Kosovës, derisa atje nuk funksionon sistemi i drejtësisë dhe nuk ka gjykata, ndërkohë ka filluar që shkalla e lartë e krimit atje t'i rrezikojë edhe t'i viktimizojë qytetarët e Kosovës, a do t'i qaseni veriu me veprime konkrete, kur, do të thotë afatet kohore dhe do të thotë përveç atyre aspekteve deklarative, sikurse ishte ajo e 25 korrikut, i cili tha që do të përsëritet- cili është plani konkret i Ministrisë suaj, i Ministrisë së Drejtësisë, që t'i funksionalizojë gjykatat në veri, afatet kohore, bazuar edhe në rezolutën e nxjerr në 28 korrik?

KRYETARI: Zëvendëskryeministër e ke fjalën.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Falemnderit, për pyetjen e nderuara deputete!

Unë kam tentuar që në debatin para dy ditësh lidhur me veriun e Kosovës, të jap një pjesë të sqarimeve edhe për angazhimet që i bën Ministria e Drejtësisë. Ne natyrisht që kërkojmë në radhë të parë që të forcohet rendi dhe ligji në tri drejtime. E para forcimi i

kontrollit kufitar, e dyta ka të bëjë me funksionalizimin e gjykatave që nënkupton sipas me një karakter unik apo sistem unik të gjitha gjykatave në Kosovë edhe në veri, pastaj me gjyqtarët e prokurorët e emëruar nga Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës, për çka vazhdimisht Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial e ka buxhetin e mjaftuar dhe me administratë përkatëse dhe e treta ka nevojë që ligjet e aplikueshme të jenë të njëjta edhe në atë pjesë të Kosovës.

Për të funksionalizuar veprimet e sistemit të drejtësisë, kërkohet që të krijohet ambient i sigurt për gjyqtarët dhe prokurorët tonë dhe në këtë drejtim kërkohet aktivitet me KFOR-in, EULEX-in dhe Policinë e Kosovës. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit!

Deputete, a ke pyetje shtesë?

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Po. Ministër, po thoni që po kërkon, obligim i juaj si Qeveri është që t'i zbatoni ligjet, që t'i zbatoni jo të kërkon se nuk jeni OJQ të kërkon. Dhe e dyta unë po dua ta tërheq vërejtjen te një deklaratë e juaja, do të thotë që 25 korriku do të përsëritet, deklaratë e cila ka sjell dëme të gjithanshme. Në rend të parë qytetarët serbë të veriut të Kosovës janë dezintegruar edhe më tepër, sepse mesazhi nga Prishtina ka qenë kërcënues dhe në rend të dytë 40 familje shqiptare janë zhvendosur, do të thotë, kanë ardhur në jug, për shkak se 25 korriku ka qenë dështim i cili qytetarëve shqiptarë të Kosovës iu ka kushtuar me jetë.

Prandaj, çka konkretisht keni menduar me thënien do ta përsëritni 25 korrikun? Dështimin, dhunën dhe do të thotë viktima të reja apo çka konkretisht si ministër i Drejtësisë keni menduar dhe në një formë keni marrë rolin e kryepolicit ose ndoshta me thënë ministrit të Punëve të Brendshme, përderisa jeni ministër i Drejtësisë? Nuk jeni fokusuar...

(Ndërprerje incizimi nga regjia)

KRYETARI: Zëvendëskryeministri e ka fjalën.

HAJREDIN KUÇI: Falemnderit, Donikë!

Unë jam zëvendëskryeministër për rend edhe ligj, nëse s'e ke ditur. E dyta, besoj që po mundohesh me lidh mozaikun sikur disa njerëz që e lexojnë parathënien e librit dhe folin për librin.

Deklaratën time nëse e lexoni mirë dhe besoj që e keni lexuar, kam thënë që nuk përjashtohet asnjë mjet juridik dhe kushtetues dhe të kërcënuar duhet të ndihen vetëm kriminelët, kudo që gjenden ata edhe në veri edhe në jug edhe kudo tjetër. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit, zëvendëskryeministër!

Deputetja Donika Kadaj – Bujupi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi. Deputete mund ta bëni pyetjen.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Falemnderit!

I nderuar kryetar!

Përsëri pyetja ime lidhet me Rezolutën e 28 korrikut, të aprovuar nga ky Kuvend.

Pika e 5 e rezolutës i kërkon, do të thotë Kuvendi i kërkon Qeverisë së Republikës së Kosovës, që të vazhdojë angazhimin e saj për vendosjen e autoritetit kushtetues atje. Ndërkohë, që edhe sot veriu vazhdon të jetë një “ishull i ndarë jashtë juridiksionit të Kosovës, ku krimi dhe dhuna po terrorizojnë jetën e qytetarëve, atje. Unë po e pyes, do të thotë ministrin e Punëve të Brendshme, se a do t’i qaseni veriut dhe kur?

KRYETARI: Zoti ministër e ke fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Çështja e vendosjes së sundimit të rendit dhe ligjit në veri është prioritet i përhershëm i Qeverisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, në veçanti. Edhe çdo ditë është prioritet dhe bashkërisht me faktorët ndërkombëtar në veri: me KFOR-in dhe EULEX-in bëjmë çmos që atje të vendoset siguria për të gjithë qytetarët dhe sundimi i rendit dhe ligjit.

Dhe edhe pse s’u përmend pyetje, megjithatë në pyetjen që e kam marrë zyrtarisht e përmendi si dështim aksionin e 25 korrikut dhe mund t’ju them se ai ka qenë aksioni më i suksesshëm prej shpalljes së Deklaratës së Pavarësisë, mos të them prej kohës së pasluftës që janë arritur objektivat edhe strategjike edhe politike edhe nacionale dhe falë atij aksioni nuk e ke në tavolinën e bisedimeve ose tryeza të ndryshme çështjen e ndarjes së Kosovës. Definitivisht, ky aksion e ka çimentuar integritetin territorial të Kosovës.

KRYETARI: Falemnderit!

Deputete, a ke pyetje shtesë?

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Ministër, ndoshta prej perspektivës tuaj ka qenë më i suksesshmi, sepse ju nuk keni ndërmarrë asnjë veprim tjetër, përveç veprimit dështues të 25 korrikut, po ky është koncepti dhe diskursi juaj.

Unë po dua me ju dhënë një vërejtje edhe për mosdhënien e llogarisë ndaj Kuvendit e cila këtë dhe deklaratës së juaj se ju nuk i përgjigjeni Komisionit Parlamentar të Kuvendit, deklaratë e cila në vendet demokratike do t’i dërgonte ministrat në shtëpi, ndërsa në Kosovë po krijoni një Republikë jo demokratike e cila në momentin kur ju po e jepni këtë deklaratë, mbi 15% të territorit të saj është jashtë juridiksionit të Kosovës, jashtë sovranitetit dhe po shkelet çdo ditë integriteti. Nëse ju po jetoni në Kosovës, unë jam shumë e befasuar se si po e konsideroni që është e arritur veprimet e Qeverisë së Kosovës në veri.

Dhe e dyta, prioriteti për të cilin ju po flisni që pesë vjet duhet t’i ketë afatet kohore, prandaj, unë do të vazhdoj t’ju pyes se kur do t’i qaseni veriut në mënyrë që qytetarët e Kosovës atje të kenë...

(Ndërprerje incizimi nga regjia)

KRYETARI: Zoti ministër e ke mundësinë për t'u përgjigjur.

BAJRAM REXHEPI: Unë edhe atëherë kam thënë se ky ka qenë një ndër hapat më të mëdhenj të Qeverisë së Kosovës dhe sfidat në veri mbesin edhe më tutje dhe do të merremi me ato, pra gjërat nuk kanë përfunduar në veri. Sa i përket kërkesës së Komisionit funksional për Punë të Brendshme dhe Siguri, natyrisht që ky komision duhet ta dijë edhe cila është përgjegjësia e tyre. Këta mund të bëjnë rekomandime, mund në mënyrë zyrtare t' i bëjnë kërkesat, po llogaridhënia nuk është drejt në këtë Komision funksional.

Unë i përgjigjem drejtpërdrejt në aspektin organizativ kryeministrit dhe kërkesës në Parlament, qoftë pyetje parlamentare, qoftë debat, qoftë informatë dhe rezolutat që dalin na obligojnë, por, Komisioni funksional nuk e ka atë fuqi ekzekutive ose obligatore për mua. Unë do t'i përgjigjem në ato raste kur shkon drejt një kontributi edhe të këtij Komisioni, po unë po e them shumë publikisht se numri më i madh i anëtarëve në këtë Komision më tepër e bëjnë për agenda politike edhe për një shou politik se sa për interes...

(Ndërprerje i nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

(Ndërhyrje)

Unë nuk jam për ta vlerësuar atë, janë ligjet dhe Rregullorja e Kuvendit është Kushtetuta dhe ai e ka përcaktuar përgjegjësitë e secilit institucion.

Deputetja Blerta Deliu – Kodra pyetje për ministrin Ferid Agani.

Ministri s'është këtu, deputetja s'është këtu. Vazhdojmë.

Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për kryeministrin zoti Hashim Thaçi. Kryeministri s'është këtu. Urdhëro, bëje pyetje deputete!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Kjo është një papërgjegjësi dhe turp për kryeministrin. Këtu po shihet se kush po ik nga seanca, pasi që nuk është hera e parë që kryeministri nuk i përgjigjet pyetjeve parlamentare.

Asnjëherë nuk kam marrë përgjigje prej kryeministrit prej kur që jam në Kuvend. Sidoqoftë, unë po e bëj pyetjen dhe pres përgjigjen në seancën tjetër. Pse kryeministri dhe Qeveria lejon aktivitete të strukturave ilegale në organizimin e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovës? Dhe, me çfarë baze ligjore dhe kushtetuese është mbështetur kryeministri kur ka deklaruar se do ta lehtësojë pjesëmarrjen në votim në organizimin e zgjedhjeve të shtetit armik serb në Kosovë? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe prej juve, por po ju drejtohem edhe deputetëve edhe Kabinetit qeveritar që të kurseni nga fjalët: turp, shpifje dhe të tilla se nuk është foltorja e Kuvendit për fyerje të tilla. Prandaj, po kërkoj që të keni kujdes në fjalorin.

(Ndërhyrje)

Vazhdojmë. Deputetja Alma Lama pyetje për ministren Vlora Çitaku. Ministrja s'është këtu, deputete mund ta bëni pyetjen.

ALMA LAMA: Po ministrja si duket është në kafe, kryeministri në kafe, ju bëfshin mirë kafet, por kjo nuk është sjellje e përgjegjshme.

Gjatë vizitës dyjavore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kemi parë në grupin e personave që shoqëronin kryeministrin edhe zonjën Çitaku e cila është ministre për Integritet dhe duke qenë se mandati i saj është për të punuar me Bashkimin Evropian, në fakt, për ta integruar Kosovën aty, pyetja ime është se cili është rezultati i vizitës së zonjës Çitaku në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për sa i përket integriteteve evropiane? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Xhevdet Neziraj, pyetje për ministrin Besim Beqaj.
Deputet e ke fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar, zoti kryetar!

Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Pjesëmarrja e komunitetit pakicë në ndërmarrjet publike është e garantuar me ligje, aneksi 2 për të drejtat e komuniteteve, si dhe neni 9, pika 9.2. Sa pjesëtarë të komunitetit egjiptas janë të punësuar në ndërmarrjet publike siç është KEK-u dhe PTK-ja?

Më ka shtyrë ta bëj këtë pyetje për shkak se para një kohe keni jep një raport për ndërmarrjet publike dhe keni deklaruar se keni 21 pjesëtarë, s'ke specifikuar po 21 pjesëtarë të tri komuniteteve dhe them të drejtën kam hulumtuar këtë rast dhe asnjë pjesëtar i komunitetit egjiptas nuk është as në KEK dhe as në PTK dhe po kërkoj ta di ku janë ata njerëz? Në veri nuk kam qasje, po për këtë pjesën tjetër kam dhe po dua ta di ku janë të punësuar ata njerëz? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër e ke fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

I nderuar deputet Neziri,

Këtë pyetje e kemi diskutuar disa herë edhe në grupet, në komisione funksionale të Parlamentit, ku iu kam dhënë shifra të sakta rreth punësimeve, të cilat janë konform obligimeve ligjore në ndërmarrjet publike dhe aty do të thotë, nëse më kujtohet mirë

numri është mbi 230 pjesëtarë të pakicave. Ligji nuk e specifikon se çfarë duhet të jenë pakicat dhe cilat janë duhet të jenë përfaqësues dhe konform informacionit që e kam dhënë edhe më herët 21 janë nga komuniteti: romë, egjiptas, ashkalinj.

Prandaj, kjo është informacioni të cilin e kemi pasur. Sigurisht që do t'ju mundësoj qasjen e drejtpërdrejtë në... do t'i pyes bordin e KEK-ut, i cili do të mund t'ju informon në mënyrë të detalizuar për këto, por çdo gjë është konform ligjit sipas obligimeve ligjore që dalin nga ndërmarrjet publike për punësimin e pakicave nëpër ndërmarrjet publike. Po flasim për pakica. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, a do pyetje shtesë?

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

Unë kam pyetje shtesë, është një arsye se nuk është mirë që dominon një pakicë, sepse tek e fundit nuk është vetëm aspekt ligjor, por edhe aspekt humanitar dhe komuniteti egjiptas është shfrytëzues i shërbimeve edhe të KEK-ut edhe të PTK-së. E është në nder në atyre ndërmarrjeve që të ketë të punësuar të tillë.

Mos të thuhet që nuk ka njerëz me përgatitje se unë kam informacione që kanë konkurruar njerëz me përgatitje superiore dhe nuk janë të ftuar as në intervistë. Sa i përket KEK-ut nga 7.000 të punësuar nuk është asnjë punëtor dhe vetëm një punëtor ka qenë i komunitetit egjiptas dhe është larguar si tepricë teknologjike. Prandaj, nuk është mirë që në ato borde nëse është një pjesëtar i një komuniteti, t'i punësojë vetëm njerëzit e komunitetit të vet. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër!

BESIM BEQAJ: Zoti deputet, unë nuk merrem me politika rekrutuese të ndërmarrjeve publike. Ministria e Zhvillimit Ekonomik është përgjegjëse për bërjen e politikave dhe zbatimin e ligjeve në raport me ndërmarrjet publike dhe monitorimin e performancës tyre menaxheriale dhe të bordeve. Ndërsa, çfarëdo lloj shkelje e ligjeve, të cilat duhet të bëhet unë mendoj që duhet të ngritet nga ju dhe të ngritet nga ata të cilët janë përgjegjës për rekrutimet të njerëzve. Por, besoj që raportet dhe informacionet të cilat kanë ardhur janë raporte korrekte, por nëse dikujt i shkelet e drejta ekzistojnë rrugët të cilat duhet të trajtohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Realisht për mbrojtjen e ligjit është dhe Qeveria dhe deputetët, Komisioni ta mbikëqyrë zbatueshmërinë e ligjeve.

Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj, pyetje për ministrin Dardan Gashi.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

Çka është duke u bërë Ministria për banimet jo formale, pasi që një numër i madh i njerëzve janë duke banuar në kushte jo adekuate të banimit, do të thotë jo dinjitetshëm dhe e kam bërë këtë pyetje për arsye se një numër i madh i njerëzve janë duke u kthyer nga diaspora dhe me qasjen ndaj vendbanimeve të tyre nuk po kanë qasje, për arsye se

po thuhet që janë banime joformale dhe çka ka bërë Ministria për këto banime jo formale?

KRYETARI: Ministër e ke fjalën!

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë të Kabinetit,

Të nderuar deputetë,

Deputeti Neziraj, janë dy çështje që ju i cekët: është njëra çështje, është çështja e kthimit të dhunshëm të personave nga jashtë dhe çështja e vendbanimeve joformale.

Sa i përket pyetjes të parë, këto javë do të thotë është hapur edhe një tender për fillimin e ndërtimit të gjashtë objekteve për këta persona që kthehen me dhunë, do të thotë nga shtetet ku ata kanë kërkuar azil dhe nuk iu është miratuar, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe me Ministrinë e Mjedisit. Kurse, sa i përket vendbanimeve jo formale ne kemi qenë të vetëdijshëm se ky problem ekziston, kemi iniciuar një studim edhe me ekspertë ndërkombëtar. Ky studim ka rezultuar se në Kosovë ekzistojnë afër 174 vendbanime tilla, ku nuk jetojnë vetëm përfaqësues të minoriteteve, por edhe popullsisë shumicë.

Ministria, në bashkëpunim me komunat përkatëse, me ministritë e linjes, ka hartuar një strategji e cila tash gjendet në Ministrinë e Financave për do të thotë, për përcaktimin e koston financiare të kësaj strategjie, do të thotë, qasjes së këtij problemi, pasi të merret përgjigja nga Ministria e Financave do të procedohet në Qeveri dhe vetëm atëherë mund t'ju themi saktë se çfarë dhe ku projekte do të ketë. Por që iu thashë për pjesën e parë, pjesën e kthimit të dhunshëm të këtyre qytetarëve, ka filluar që të zgjidhet problemi dhe besoj se brenda vitit edhe përfundimi i ndërtimit do të realizohet. Ju faleminderit!

KRYETARI: A ke pyetje shtesë deputet?

XHEVDET NEZIRAJ: Kam pyetje shtesë për arsye se në një dokument thuhet se Ministria për Planifikim Hapësinor ka filluar strategjinë në vitin 2010 dhe strategjia duhet të lëvizë prej pikës A në pikën B. Unë po e shoh që ende strategjia nuk ka filluar të lëvizë asnjë milimetër. Kur do të fillojë? Sot, nesër apo mbas një viti?

KRYETARI: Ministër e ke fjalën.

DARDAN GASHI: Faleminderit zoti kryetar!

Zoti deputet unë ju thashë edhe më herët se strategjia duhet të ketë edhe një bazë financiare. Ne tash jemi duke pritur do të thotë miratimin e buxhetit për implementimin e kësaj strategjie. Strategjia gjendet në Ministrinë e Financave dhe besoj, shpresoj se në rishikimin financiar në qershor, do të kemi mundësi që t'ju japim një përgjigje të saktë se sa buxhet do të ketë për këtë vit dhe për vitin e ardhshëm, për qasjen ndaj këtij problemi.

Mirëpo, ju siguroj se është Ministria, Qeveria në përgjithësi e përkushtuar që të merret me këtë problem, është edhe obligim i Qeverisë dhe do të thotë, miratimi i buxhetit është ajo e cila edhe na ndan nga një informatë konkrete për ju. Falemnderit!

KRYETARI: Dhe, kështu kemi ardhur te pika e tretë e rendit të ditës-

3. Shqyrtimi i dytë i Projekt Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projekt Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ka fjalën kryetari i Komisionit, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Falemnderit, kryetar!

Projekt Kodi Penal i Republikës së Kosovës është njëri ndër ligjet më të rëndësishme, ligj i cili e ka marrë kohë që të studiohet dhe të amendamentohet nga Komisioni funksional.

Komisioni ka punuar dhe ka bërë një punë jashtëzakonisht të mirë. Janë propozuar 58 amendamente. Ka shumë amendamente, sepse edhe vetë volumi i ligjit është shumë i madh dhe besoj se ka pasur një përmirësim cilësor të Projekt-kodit. Janë disa elemente që deputetët besoj që duhet t'i vëmë në dijeni. Kryesisht tendenca e Komisionit ka qenë që ndëshkimi për veprat penale të rritet dhe pothuajse të gjitha veprat penale, sidomos te vepra penale e krimeve seksuale kundër të miturve janë rritur ndëshkimet. Janë hequr ndëshkimet lidhur me mediat dhe përfaqësuesit e tyre dhe përgjegjësinë penale të përfaqësuesve dhe drejtuesve të mediave në rast të publikimit të informacioneve të pavërteta. Unë mendoj se nuk është dashur me u heq, mirëpo ka pasur një konsensus mes Ministrisë dhe Komisionit dhe është hequr. Po ashtu, punë e mirë është bërë në të gjitha nenet tjera dhe besoj se kemi një produkt cilësor i cili duhet të votohet në Kuvend. Një element, të cilin do ta vërejnë deputetët dhe mund të kenë pyetje - pse është ndryshuar hyrja në fuqi e këtij ligji? Arsyeja është se është një ligj shumë voluminoz e para, e dyta një ligj prek sistemin dhe e treta, një ligj i tillë për të hyrë në fuqi duhet të përgatitet i tërë sistemi. I tërë sistemi nënkupton përgatitjen e gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve, të cilët do ta zbatojnë këtë ligj dhe u duhet kohë derisa të përgatiten.

Dhe, po ashtu njëjtën kohë pritet që shumë shpejtë të vijë në Kuvend edhe Ligji për procedurën penale. Ky ligj rregullon procedurat e zbatimit të Kodit dhe besoj që do të jemi në një situatë më të mirë të zbatimit të këtij kodi. Prandaj, unë besoj se është një vendim i qëlluar i Komisionit që Kodi të hyjë në fuqi më datën 1 janar të vitit 2013. Nuk ka ndonjë arsye buxhetore ose financiare, sepse nuk ka kosto shtesë financiare, por është thjesht zbatimi më i mirë i tij dhe përgatitja e sistemit, si në aspektin kuadrovik dhe profesional po ashtu edhe në aspektin e ligjeve përkrahëse që në këtë rast është Kodi i Procedurës Penale. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit, deputet!

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve. Nëse ke për amendament kur vjen fjala te amendamenti e merr fjalën.

(Ndërhyrje)

Jo, për Kodin në tërësi e tha kryetari i Komisionit dhe vetëm për amendamentet kur vjen, e ke bërë amendamentit e merr fjalën. Nuk ka Grup, as... jo nuk ka.

Vazhdojmë me votimin e amendamentit të parë.

“Kundër”? S’ka.

Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Amendamenti 2.

“Kundër”? S’ka.

Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Amendamenti 3.

“Kundër”? S’ka.

Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Amendamenti 4.

“Kundër”? S’ka.

Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Amendamenti 5 propozim i deputetes Alma Lama, me përkrahjen e Komisionit funksional. A ka “kundër”? Nuk ka.

Abstenim s’ka.

Miratohet.

Në amendamentin e 6 kemi dy propozime: a). Propozimi i Komisionit funksional dhe b). Propozimi i deputetes Alma Lama, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Deputete e ke fjalën për ta sqaruar amendamentin.

ALMA LAMA: Falemnderit, zoti kryetar!

Së pari dua ta falënderoj komisionin që e ka marrë parasysh amendamentin tim në lidhje me nenin 37, i cili po të miratohej ashtu siç ishte do të cenonte drejtpërdrejt lirinë e mediave.

Për sa i përket nenit 38, unë kam kërkuar që të hiqet pika 2 i cili ka të bëjë me nxjerrjen e burimit të informatës. Në të vërtetë nxjerrja e burimit të informatës është një nga çështjet më të komplikuar sot në botë, veçanërisht kur kemi të bëjmë me publikim të sekretit shtetëror.

Neni 38, pika 2 e Kodit Penal i cili kërkon nxjerrjen e burimit vetëm për disa raste specifike kur kanë të bëjnë me vepra të rënda ndaj të miturve, përdhunimeve etj., pavarësisht se janë krime të shëmtuara dhe të rënda, detyrimi i gazetarit për të nxjerr burimin e informacionit, gjithashtu është pengesë në punën e gazetarëve dhe madje mund të rrezikojë edhe jetën e tyre. Në Shtetet e Bashkuara, për shembull kemi disa gazetarë, të cilët janë detyruar të vuajnë dënimin me burg për faktin se nuk kanë pranuar të tregojnë para gjykatës burimet e tyre të informacionit.

Problemi i ruajtjes së konfidencialitetit të burimit është esencial për punën e gazetarëve. Në rast se do të ekzistonte një instancë gjyqësore e cila do t'i detyronte ata të tregonin burimin, liria e medias do të cenohej, gazetarët nuk do të mund të kryenin misionin e tyre pasi vetë burimet nuk do të mund t'ju besonin më, sepse ata do të ndiheshin të rrezikuar se një ditë do të zbuloheshin. Dhe, në një rast të tillë sigurisht që do të preferonin të mos flisnin. Pa një mbrojtje të tillë burimet do të përmbaheshin nga informimi i shtypit për çështje të cilat kanë interes të madh për publikun. Si rezultat roli vital mbikëqyrës që kanë mediat do të nënvlerësohej dhe mundësia që shtypi të prodhojë informacione të sakta dhe të besueshme do të ndikohej negativisht.

Padyshim që media në një situatë të tillë nuk do të ishte më fuqia e katërt, që është tani. Janë të pafund shembujt në historinë e gazetarisë amerikane që kanë të bëjnë me rëndësinë që ka ruajtja e burimit, por rasti më i njohur mbetet ai i skandalit Watergate, pa burimin e tyre anonim me pseudonimin Deep throat, gazetarët e Uashington Post nuk do të mund të realizonin kurrë artikujt që quan në rrëzimin e një presidenti. Ishte pikërisht ky burim i cili iu jepte atyre informatat. Vetëm në vitin 2005 bota kuptoi se kush ishte Deep throat, 40 vjet më pas, pra. Kur ai vendosi që këtë ta bënte vetë, ta bënte vetë publike.

Në fakt gazetarët nuk u detyruan asnjëherë të jepnin burimin, por Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë rasti më i mirë për t'u marrë si shembull edhe për diçka tjetër, 40 nga 50 shtetet kanë miratuar ligj të veçantë për mbrojtjen e gazetarëve, quhet Shield Low. Ndërsa, shtete të tjera ndjekin më shumë praktikat gjyqësore rast pas rasti. Zoti kryetar, si duket deputetët i dinë mirë këto gjëra dhe s'kanë nevojë të dëgjojnë.

Në bazë të këtij ligji gazetarët nuk detyrohet të nxjerrin burimin e informacionit, nuk thirren në gjykatë për të dëshmuar dhe materialet e tyre të punës nuk mund të konfiskohen nga policia si dëshmi. Këtu në Kosovë është e vështirë të kuptohet kjo, pasi policia vrapon të mbledhë dëshmi nga gazetarët, mirëpo për ta bërë të qartë çështjen e ruajtjes së burimit të informacionit në të cilin gazetari ka një marrëveshje etike, duhet të

sjellim ndërmend edhe punën e avokatit i cili e mbron klientin e tij dhe madje ky i fundit ndëshkohet nëse vepron kundër interesave të klientit. Në Evropë Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vitin 1996 në rastin Godwin kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendosi që mbrojtja e burimeve nga gazetarët është një nga kushtet kryesore të lirisë së mediave. Gjykata vendosi se pengimi i kërkesës themelore të interesit publik do të ishte shkelje e nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Edhe pse në Kodin Penal të Kosovës kërkohet nxjerrja e burimit për të parandaluar sulmin që përbën kërcënim të pashmangshëm ndaj jetës apo integritetit trupor të ndonjë personi dhe disa vepra të tjera penale të përmendura më sipër, liria e gazetarëve cenohet në të njëjtën mënyrë pasi nuk është puna e tyre as ajo e policit dhe as ajo hetuesit. Në rast se ka marrë një informacion në besim ai duhet t'i qëndrojë besnik burimit dhe të kryejë vetë misionin e tij, pra informimin e publikut.

Mbrojtja e burimit në përgjithësi, pavarësisht nga rastet specifike është në interes të publikut. Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha këto argumente, unë i ftoj deputetët e Kuvendit të Kosovës që të votojnë pro këtij amendamenti. Falemnderit!

KRYETARI: Veç keni gjithnjë parasysh që jemi në Kosovë edhe mediave mos t'u japim shumë hapësirë për të shpifur, e kanë të drejtën e tyre, por nuk jemi në Amerikë, ajo që dyqind e sa vjet e ndërton demokracinë.

Fjalën e ka Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Falemnderit, kryetar!

Besoj që ka këtu një keqkuptim edhe një keq citim, sepse ju mund ta dini se fshehja e një informate e cila ka si mundësi rrezikimin e jetës, trupit, shëndetit të tjetrit apo mosdhënia e një informacioni i cili rrezikon sigurinë publike, përbën vepër penale dhe në këtë rast kësaj vepre penale nuk mund t'i ik kurrkush as gazetarët, as kushdo që të jetë, por pjesëmarrës në vepër penale duke fshehur qëllimisht një informacion i cili mund të rrezikojë trupin, jetën dhe shëndetin e tjetrit ose sigurinë publike. Prandaj, të kemi parasysh se këto elemente janë shumë të ndjeshme dhe nuk duhet të lejojmë që struktura të caktuara ose njerëz specifik t'i kemi përjashtim prej ligjit. Përballë ligjit të gjithë jemi të barabartë dhe në qoftë se dikush konsumon veprën penale në këtë rast, gazetar apo deputet është përgjegjës përballë ligjit dhe në qoftë se e ka konsumuar këtë vepër penale si pjesëmarrës, në këtë rast kualifikohet si pjesëmarrës pasiv në vepër penale duke mos deklaruar rrezikun ndaj trupit, jetës dhe shëndetit apo sigurisë publike.

Të jemi të singertë me këto punë dhe unë mendoj se edhe neni paraparak i cili kaloi nuk është dashur të jetë, sepse përhapja e informacionit që dëmton integritetin dhe personalitetin e tjerëve përbën problem, mirëpo kaloi dhe jemi në këtë nen i cili nuk duhet përkrahur dhe besoj që duhet të kalojë siç e kalon Komisioni funksional. Falemnderit!

KRYETARI: Jo, ai që e merr fjalën njëherë nuk ka me marrë dy herë, vetëm nganjëherë për Grup Parlamentar.

I nderuari kryetar i Komisionit,
Amendamenti 5 që u votuar thotë: “propozimi i deputetes Alma Lama, me përkrahjen e Komisionit funksional”

Edhe Xhavit Haliti do ta shpreh mendimin personal.

(Ndërhyrje)

XHAVIT HALITI: Unë mendoj që për Kodin Penal nuk vlen asnjë lloj marrëveshje në mes asnjë ministri, as me gazetarët e as me asnjë grup të interesit cilido qoftë ai.

Po e them, sepse jam njëri nga ju këtu që propaganda që është bërë me mediat, sepse unë s’kam pronë media, por nga ata që i kanë pronë, është bërë për më shumë se 10 vjet gjenocid ndaj meje nga mediat dhe këto media vazhdojnë me çdolloj dezinformate, mezi presin që dikush del ta bëjë një dezinformatë në njërin televizion ose në një gazetë dhe pastaj t’i shpërndajnë këto si rreze drite, si informacion i vërtetë. Nuk e besoj që ka vend në botë e as në Evropë, meqenëse po thirren në ligjet evropiane, që përjashton nga dënimi shpifësit, që përjashton nga përgjegjësia ata që shpifin kundër individit, kundër figurave publike, kundër kujtdo qoftë.

Mendoj që llogaridhënia duhet me qenë dhe amendamentin e 5, dhe pikërisht për shkak të amendamentit të 5-të, meqenëse u votua këtu, unë e thërras presidenten e Kosovës, që të mos e miratojë dhe ta kthejë në rishqyrtim, pikërisht për shkak të kësaj dhe ky duhet të shkojë kudo qoftë, në gjitha instancat, jo të brendshme edhe në Gjykatë Kushtetuese, edhe tek presidentja, që të mos miratohet amendamenti 5, i cili liron nga përgjegjësia penale shpifësit, të cilët janë të paguar dhe janë të shtyrë nga segmente dhe njerëz të caktuar. Për atë arsye po them unë që nuk bën të përjashtohet. Unë kam pasur një histori, po e them jo të këndshme me ndonjërin nga gazetatat tona edhe në Zvicër që po mendoj që është shtet më demokratik se i Kosovës, unë kam fituar procesin gjyqësor dhe nuk iu ka ardhur keq që të dënohen dhe nuk janë konsideruar gjykatat zvicerane si shkelëse të drejtave as të informimit, as të gazetës, as të gazetarëve, as të së vërtetës.

Prandaj, detyrë parësore e gazetarëve është që ta thonë të vërtetën që ta hulumtojnë të vërtetën dhe ta pasqyrojnë të vërtetën, por jo që të lirohen nga përgjegjësia në qoftë se shpifin nga kujtdo qoftë. Falemnderit!

KRYETARI: Fjalën e ka zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, sponsoruesi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Falemnderit!

Unë besoj që këtë që e përmendi edhe zoti Haliti, besoj edhe deputetët e Komisionit që kanë qenë e dinë që në fazën kur vjen ligji në Kuvend, pastaj Ministria s’e ka asnjë ndikim edhe në rastin konkret besoj që Komisioni s’ka marrë asnjë ndikim.

Por, ajo çka dua të them drafti i parë i projektligjit që ka ardhur, projekt kodit në Kuvend, ka ardhur i miratuar nga Ministria, nga Qeveria, nga ekspertë vendorë dhe më shumë

ndërkombëtarë dhe pastaj keni filluar me më qit në tapetë edhe opinionin publik, edhe mediat, edhe disa deputetë duke dalë që unë jam anti-media dhe të tjerët qenkan pro mediave. Dhe, kjo ka qenë arsye se kam thënë “qysh doni bëni” dhe kuptimi i saj është pra, nuk kam qenë unë ai që kam ndryshuar qëndrim, por ka qenë opinionin publik dhe që asnjëri në këtë sallë e as jashtë kësaj salle, nuk ka thënë që ministri ka të drejtë, përkundrazi konstatimet edhe të atyre që sot po flasin ndryshe kanë qenë pak më ndryshe. Dhe, ajo çka dua të them është edhe te rasti që përmendi deputetja Lama, këtu kemi të bëjmë me burimin kur kryhet vepra penale përmes tyre, nuk kemi të bëjmë me çdo burim.

Dhe, unë po e them mund të jetë burimi për një akt terrorist, këtë duhet ta tregojë gazetari, shikoni, ju, ka plotë raste, tash nuk është koha e ligjëratave po ata që janë juristë e dinë këtë mirë. Edhe ka mundësi që përmes burimit të kryhet vepra penale dhe vetëm kur kryhet vepra penale kërkohet burimi, jo në rastet tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se është jashtëzakonisht e rëndësishme kjo pikë e rendit të ditës për të cilin po flasim sot, është jashtëzakonisht i rëndësishëm edhe debati mu për këtë nen, për shkak se po flasim për disa elemente që janë esenciale, do të thotë thelbësore për mënyrën se si ne iu qasemi problemeve e që ka ndërlidhje me shumëçka: me mediat, me demokracinë, me sundimin e ligjit edhe me aftësinë e institucioneve tona për t’i zbuluar krimet, domethënë të krijojnë siguri te njerëzit.

Unë kisha dashur me e vu llupën vetëm të një aspekt të cilin e përmendi Alma dhe sinqerisht nuk e kam në plan as të bëhem avokat i gazetarëve e as i mënyrës së hetimit, por të provoj me mbërri deri te një pikë kur ne e mundësojmë pak më mirë zbulimin e krimit. Tani ne po flasim për atë se a duhet të detyrohen gazetarët ta zbulojnë burimin e informatës, s’po flasim për informatën se informata kur del, del në gazetë ose në televizion dhe nuk po flasim këtu a duhet zbuluar informatën gazetari. Po flasim për momentin kur ai e ka zbuluar informatën, po kërkojmë ose po mendojmë a duhet ta zbulojë burimin apo jo?

Tani mendimi im është kështu, nëse kërkojmë burimin e informatës dhe nëse me ligj i obligojmë gazetarët që ta zbulojnë burimin e informatës, një gjë ndodh, ata që mund ta japin burimin nuk do t’ju japin gazetarëve, nuk do t’ju japin burimin, nuk do ta tregojnë informatën për shkak se rrezikojnë të zbulohen, për shkak se rrezikojnë se një gjyq e thërret gazetarin dhe e obligon ta zbulojë burimin. Tani unë po mendoj a më shumë i ndihmon siguri e edhe sundimit të ligjit një informatë, qoftë edhe pa burim, apo i ndihmon më shumë sundimit të ligjit, pengimi i dhënies të asaj informate definitivisht prej kryerësve të veprave kriminale? Mos harroni kryerësit e veprave kriminale për një javë e marrin vesh cili është ligji.

Do të thotë, ajo që do të vendosim sot është, a do t’i lejojmë gazetarët me marrë informata apo do t’i detyrojmë kriminelët mos me iu dhënë gazetarëve informata fare? Dhe mendoni, këto çështje janë diskutuar shumë gjatë nëpër vendet tjera të botës dhe me

siguri ata nuk kanë qenë naiv pse kanë ardhur deri te përfundimi se ndoshta më tepër i ndihmohet sundimit të ligjit duke e ruajtur gazetarin prej detyrimit për ta dhënë informatën.

Çështje tjetër që u tha këtu po më duket se e përfundova këtë pjesë, personalisht mendoj se nuk duhet t'i detyrojmë gazetarët ta japin burimin e informatës, informatën po. E, edhe mos harroni se edhe gazetarët janë njerëz, nuk janë subjekte elektronike të cilat programohen dhe veprojnë në mënyrë të njëjtë. Nuk besoj se duhet të nisemi prej faktit se të gjithë gazetarët do ta ... terrorizmin, shembull, ta marrim. Nuk po flasim këtu t' i detyrojmë gazetarët mos me e dhënë burimin e informatës ... a munden me e dhënë nëse e shohin si rrezik, rrezik të përgjithshëm për jetën e shumë qytetarëve, kjo është çështja?

Dhe, çështja e dytë është tek shpifja. Unë mendoj se është absolutisht e drejtë në aspektin e shpifjes ajo që tha deputeti Xhavit Haliti. Nuk guxon të lejohet në Kosovë mundësia që dikush të shpifë, qoftë kundër zyrtarëve të lartë të shtetit, qoftë kundër mjekëve, kundër kujt do qoftë në Kosovë dhe të kalojë i padënuar. Mirëpo, ky nen nuk ka të bëjë me shpifjen për shkak se edhe nëse gazetari nuk e jep burimin e informatës, mund të vërtetohet lehtë a ka qenë shpifje a jo, do të thotë vërtetimi se a është shpifje apo nuk është shpifje jo domosdoshmërisht e kërkon që gazetari ta jep burimin e informatës. Një shpifje vërtetohet se është shpifje nëse vërtetohet që nuk është e vërtetë.

Edhe mendoj se prapë ky nen nuk ka të bëjë me shpifjen, mendoj se kjo çështja e shpifjes duhet ndoshta të rregullohet edhe me aktet tjera, jo vetëm me Kodin Penal. Jam absolutisht i bindur se duhet të pengohet shpifja po jo përmes këtij neni, jo përmes kësaj pjese të Kodit Penal. Faleminderit!

KRYETARI: Armend Zemaj pasi ka qenë anëtar i grupit punues.

ARMEND ZEMAJ: Kryetar, faleminderit shumë!

Rendi e do që të flasë kryetari i Grupit punues se kemi folur dhe kemi punuar së paku 3 muaj ditë dhe në mënyrë shumë aktive, zoti Behar Selimi, Albulena, Armendi edhe të tjerët që kanë kontribuar në forma të ndryshme.

Kjo është e para çka dua të them dhe është ndoshta praktikë e mirë që të flasim ata që kanë qenë në ngjarje dhe kanë kontribuar që ky Projekt Kod i rëndësisë së veçantë t'i ketë kualitetet e veçanta dhe të jetë në interes të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faktikisht, ne me vëmendje dhe me sinjeritet shumë të madh, e kemi trajtuar këtë çështje, pavarësisht opinionit të krijuar edhe përmes mediave edhe përmes interesave të deputetëve në raport edhe me Ministrinë e Drejtësisë, por edhe me Komisionin po edhe ne si Grup punues, të cilët kemi qenë shumë aktiv në këtë drejtim dhe shumë seriozitet i kemi dhënë. Pavarësisht që deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, mediat, shoqëria civile nuk i ka interesuar fare temat me rëndësi apo kualiteti i këtij Kodi apo gjërat, risitë që janë futur në këtë Projekt Kod, siç janë vepra të tjera shumë të rëndësishme, por janë ndalur pikërisht në këtë temë, sepse prekin interesa komerciale.

Këtë me sinjeritetin më të madh po e them, nuk janë trajtuar krimet seksuale çka po bën, nuk janë trajtuar veprat penale që kryhen, vjedhjet, nuk janë trajtuar krimet e rënda

serioze, nuk është trajtuar dënimi me vdekje, domethënë, të gjitha këto kanë mbetur vetëm kompetencë e Komisionit, Krimet ndaj shtetit dhe shumë gjëra e gjëra tjera, prandaj, pa dashur të ndalem në këto interpretimet dhe teoritë që mund të jenë shumë të mira edhe për deputetët edhe për vetë qytetarët e vendit, unë vetëm po e jap një sqarim: në Grupin punues dhe në Komisionin kanë punuar njerëz që punojnë në drejtësi që 30-40 vjet, duke filluar nga përfaqësues amerikanë, Komisioni Evropian, miqtë tjerë EULEX, OSBE, e gjithë të tjerët e kemi ardhur në këtë përfundim që neni 38, paragrafi 2 i Kodit Penal, domethënë, të mos fshihet në tërësi, sidomos që ka të bëjë me zbulimin e informacionit për parandalimin e kryerjes veprave penale dhe janë shumë mirë të specifikuara.

Jeta e njeriut në Kosovë është shumë më e vlefshme se sa zbulimi i një informacionit. Nëse thirremi ne në shembuj jashtë vendit e kemi shembullin që e përmendi edhe kolegja është rasti Murdok në Angli, ku Gjykata e Lartë e sjell vendimin dhe thotë kështu: “çdo media, çdo organizatë e ka për obligim të ndihmojë policinë në zbulimin e krimeve serioze dhe nuk do koment tjetër” Nëse e marrim shembull SHBA-n, prokurorja e lartë e shtetit që ka punuar me neve, jo që e detyron për ta zbuluar informacionin apo që quhet ajo siguria nacionale që ka, po nuk ka qare pa e zbuluar informacionin, sepse jeta e qytetarit edhe e vendit është shumë më e vlefshme.

Nëse e marrim na shembuj këtu në Kosovë, janë dëmtuar njerëz, janë dëmtuar familje me mos zbulim të informacionit apo me paragjykim të informacionit. Prandaj, zoti kryetar përkrhane propozimin e Komisionit funksional edhe pse shembujt, të drejtave të njeriut janë të vlefshme edhe ne i kemi marrë shumë parasysht. Edhe ekspertët vendorë, edhe ndërkombëtarë nuk po paragjykojmë e drejta në jetë është më e vlefshme se sa e drejta komerciale e mediave.

Para tri dite e keni pasur në Stokholm të Suedisë, është shtet i Bashkimit Evropian, e keni pasur kur një gazetar, rastësisht kishte qëlluar shqiptar, e ka bërë një hulumtim për kontrabandimin me armë, e ka blerë një armë. Gjykata e detyron, sepse ai dëshiron ta ruajë jetën e qytetarëve dhe ka qenë publike. Prandaj, këto janë shumë shembuj që ne si Kuvend i Republikës së Kosovës, më e rëndësishme është jeta e qytetarëve të vendit, jeta e njeriut se sa interesat e mediave të caktuara, që merren me gazetari hulumtuese ose diçka tjetër. Dhe, kjo nuk e cenon! Shikoni nenet tjera, e mos u lidhni vetëm me një nen. Nuk e cenon pavarësinë e mediave.

Me bindje të plotë, me përgjegjësi të plotë, jo vetëm unë po edhe anëtarët tjerë të komisionit, i kemi hequr këto dilema. Me shumë korrektësi po e them, sepse pavarësisht asaj propagande dhe atij vrulli që ka qenë në këto nene dhe nuk ju ka interesuar, tash ju do t'i shihni amendamentet tjera. Ne i kemi rritë veprat penale, apo minimumin e veprave penale. Nuk i ka interesuar kurrkujt me na pyet: pse po i rritni këto vepra penale?!

(Ndërhyrje)

Po, s'kam pas nevojë ty me t'i bë publike, se s'ke lidhje me këtë punë! Falemnderit shumë!

KRYETARI: Falemnderit! Deputeti Behar Selimi, e ka fjalën!

BEHAR SELIMI: Falemnderit, kryetar!

Të nderuar deputetë, po flet kryetari i Grupit Punues! Unë, siç është e zakonshme ndër ne, ata që punojnë shumë s'iu bie me folë shumë, por megjithatë unë do të flas dhe do të flas shkurt.

E para, nuk ka punuar Grupi Punues nën ndikimin e asnjë lloj marrëveshjeje. Ne kemi pranuar amendamente, që na kanë ardhur nga deputetët dhe na kanë ardhur nga Ministria e Drejtësisë dhe i kemi shqyrtuar sipas procedurës ato amendamente.

Është punuar kohë të gjatë. Është punuar në mënyrë të hapur, me të gjithë ata të cilët kanë qenë të interesuar që të ndihmojnë me punën rreth përpilimit të amendamenteve.

Është votuar në mënyrë të rregullt në komision. Rezultati i atij votimi sot është në këto amendamente, prandaj është çështje tjetër pastaj se kush e si mendon.

Unë ju ftoj që të mos frikohemi prej lirisë, në njërin anë. Në anën tjetër, edhe ata, të cilët janë të shqetësuar për lirinë e informimit le ta kenë parasysh se liria e informimit ka të bëjë prapë me njeriun dhe kryefjala e çfarëdo lirie dhe të drejte të njeriut, është vetë njeriu. Dhe, për sa kohë që duhet ta ruajmë jetën e njeriut duhet edhe ta marrim burimin e informacionit, kur na duhet për ta ruajt jetën e njeriut.

Ju ftoj që t'i votoni amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, të cilat janë votuar në Komisionin FunkSIONAL! Falemnderit!

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Ju lutem! Unë po kërkoj nga komisioni apo nga kryetari i komisionit!

Ne e votuam një amendament, që ka vërejtje - amendamenti 5.

Prandaj, nëse ju jeni dakord, me një votim formal e rikthejmë edhe një herë këtë, që të mos na kthehet më, sepse realisht, ky ligj është shumë gjithëpërfshirës dhe nuk është mirë të shkojë siç ka shkuar.

Unë jam i obliguar këtë tua them e që mos të merremi edhe njëherë me këtë ligj. Kryetari i Komisionit, deputeti Arben Gashi, e ka fjalën!

ARBEN GASHI: Falemnderit, kryetar!

Këtu u krijua një tollovi dhe po krijohet edhe një keqkuptim. Amendamenti 5, kaloi dhe e rrëzoi nenin i cili parashikon si vepër penale - përhapjen e informacionit të pasaktë, me qëllim të dëmtimit të imazhit të tjetrit.

Kjo kaloi dhe për mendimin tim, nuk është dashtë me kalua. Unë edhe në komision kam votuar kundër, por Komisioni e ka përkrahë dhe kur votohet në komision, unë këtu pastaj e deklaroj mendimin e komisionit.

Nëse deputetët nuk kanë qenë të qartë se çka është votuar, munden me e marrë edhe një herë në konsideratë.

Amendamenti 6, ka të bëjë me burimin e informacionit. E para ke përhapja e informacionit të pasaktë, me qëllim të dëmtimit të imazhit të tjetrit.

E dyta, ka të bëjë me burimin e informacionit, i cili e rrezikon trupin, jetën dhe sigurinë e shëndetit të individit apo sigurinë e përgjithshme.

Këto janë dy amendamente. Nëse seanca vendos, që me i kthye, mundet me i kthye edhe me e marrë në konsideratë.

Por, propozimi, që ka ardhur prej Ministrisë, është se përbën vepër penale nëse ti përhapë informacion të pasaktë me qëllim të dëmtimit të imazhit të tjetrit.

(Ndërhyrje – reagim)

Veç ta përfundoj! Seanca e mori një vendim. Nëse do me e ri-konsideruar, është çështje e seancës.

Çështja e nenit 6, është hala ma thellë me shkua në problem. Nëse si rezultat i një informacioni, që kushdo që e ka, e në këtë rast edhe gazetari, po kushdo që e ka, e ka një informacion që përbën rrezik për jetën, trupin dhe shëndetin e tjetrit apo sigurinë publike e nuk deklarohet, përbën vepër penale. Kjo është vepër penale. Dhe, je bashkëpjesëmarrës në vepër penale, bashkëpjesëmarrës pasiv, sepse nuk e ke deklaruar rrezikun që i kanoset dikujt tjetër.

Mirëpo, këtu po synohet që me pa vetëm nga këndi i gazetarëve apo të njerëzve që munden me përdorë dhe publikisht me përhapë një informacion. Unë mendoj që të dyja është dashtë me përbëjnë vepër penale.

E kam thënë në komision, po e them edhe sot, që të dyja duhet me përbë vepër penale, sepse është vepër penale në qoftë se ti qëllimisht e dëmton integritetin personal dhe profesional të tjetrit, përhapë një informacion të pasaktë.

Çka do të ndodhë, sepse ne e kemi pas rastin me librin e Hitlerit “My kamp”. Ai shitet sot në Kosovë, ndërsa në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian është i ndaluar. Kush mbanë përgjegjësi? Me këtë ligj ne nuk mundemi me e dënua. Nuk është vepër penale. Është përhapje e urrejtjes dhe me këtë ligj, ne nuk po e trajtojmë si të tillë. Ne si shoqëri duhet me vendosë: a domi përhapjen e urrejtjes ose përhapjen e informacionit të pasaktë për tjetrin me e dënua apo nuk domi?

Me vendimin që u mor, nuk dom me e dënua. Pra, me amendamentin 5, nuk e dënojmë. Kjo është!

KRYETARI: Me Kushtetutë, është e ndaluar! Unë kërkoj nga seanca të deklarohet për rikthimin e amendamentit 5.
Regjia, gati!

Kush është për, me një votim formal?

Kush është kundër? Falemnderit!

Seanca miraton rikthimin e amendamentit 5.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë për heqjen e amendamentit 5. Votojmë tash:

Me 53 vota për, 23 kundër dhe 2 abstenime, nuk miratohet amendamenti 5.

Tash e votojmë amendamentin 6, të Komisionit Funksional. Votojmë tash:

Me 62 vota për, 19 kundër dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 6 i Komisionit Funksional.

Votojmë amendamentin 7.

Ka kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet!

Amendamenti 8.

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet!

Amendamenti 9.

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet!

Amendamenti 10.

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet!

Amendamenti 11.

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka.

Miratohet!

Amendamenti 12.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 13.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 14.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 15.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 16.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 17.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 18.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 19.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 20.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 21.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 22.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 23.
Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 24, i ka dy propozime:
- Propozimi i parë, është i Komisionit Funksional.
- Propozimi i dytë i deputetit Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.
Bekim e ke fjalën!

BEKIM HAXHIU: Falemnderit, i nderuar kryetar!
Pasi që komisioni e ka marrë për bazë propozimin e amendamentit nga unë dhe ka bërë një ndërhyrje dhe për ata se amendamenti është i komisionit, domethënë, jam të përkrahet mendimi i komisionit, në këtë rast.

KRYETARI: A ka kundër, në amendamentin 24, i propozuar nga Komisioni Funksional?
Nuk ka.

Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 25, ka dy propozime:
- Propozimi i parë është i Komisionit Funksional dhe,
- I dyti i Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Deputet, e do fjalën? Regjia, fjalën deputetit Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Falemnderit, i nderuar kryetar!
Edhe këtu është e njëjta çështje, vetëm se komisioni është më konciz, domethënë, te shqiptimi i dënimit, prandaj e përkrah edhe unë mendimin e komisionit, në këtë rast.

KRYETARI: Falemnderit!
A ka kundër, amendamentit 25 të Komisionit Funksional? Nuk ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 26.
Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 27.
Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 28.
Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 29.
Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 30.
Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 31.
Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 32.
Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 33.
Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 34.
Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 35.
Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 36.
Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 37.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 38.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 39.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 40.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 41.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 42.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 43.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 44.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 45.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 46.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 47.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet!

Amendamenti 48.

Kundër? S'ka.
Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 49.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 50.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 51.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 52.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.
Miratohet!

Amendamenti 53, i propozuar nga deputetja Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Deputete e ke fjalën! Nuk është këtu! Atëherë, shkojmë në votim!

Do të thotë, amendamenti 53 është i deputetes Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash:

Me 12 vota për, 54 kundër dhe 5 abstenime nuk miratohet amendamenti 53.

Në radhë është amendamenti 54, i propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Deputet, do ta marrësh fjalën? Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën!

BEKIM HAXHIU: Falemnderit, i nderuar kryetar!

Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Te ky amendament, kërkoj përkrahjen e kolegëve deputetë dhe për shumë, arsyet janë këto:

Kam propozuar që huliganizmi të trajtohet si vepër penale. Në veçanti zhvillimet e fundit huligane, në terrene sportive, e argumentojnë nevojën që huliganizmi të trajtohet me Kodin e ri Penal.

Unë kam propozuar, që huliganizmi të trajtohet si vepër penale, me qëllim që kryerësit e veprimeve të tilla huligane, të dënohen në bazë të Kodit Penal, por edhe me qëllim të mbrojtjes së qytetarëve, personave zyrtarë dhe objekteve publike apo private, gjatë aktiviteteve sportive, nga sulmet huligane.

Ky propozim imi bëhet me qëllim të parandalimit të veprave të tilla, në mbrojtje të të drejtave dhe integritetit trupor, për të ngritur prestigjin e pjesëmarrësve në sport dhe të personave zyrtarë si dhe mbrojtjes së pronës publike dhe private.

Me Kodin e ri Penal, parashihet vepra penale nga dhuna në grup, por nuk trajtohet huliganizmi si vepër e veçantë penale.

Ngjarjet e fundit duhet të na solidarizojnë dhe sensibilizojnë të gjithëve për të bërë një hap më shumë, për të ndërtuar mekanizmin e saktë ligjor, për të ndëshkuar ata, të cilët po dhunojnë sportin në Kosovë. Dhe, me aprovimin e këtij amendamenti ne do t'i hapim rrugën edhe krijimit të një ligji kundër huliganizmit.

Në terrenet tona sportive, ka pas disa rrahje masive dhe veprime huligane, andaj është e domosdoshme, që këta huliganë të ndëshkohen në bazë të Kodit të ri Penal dhe e kërkoj përkrahjen tuaj, dhe të nderuar kolegë deputetë me votën tuaj “pro” këtij amendamenti, ju do të votoni “pro” ndëshkimit të atyre që kryejnë vepra huligane. Në të kundërtën ju do të stimuloni ata, që po kryejnë vepra huligane dhe po dhunojnë sportin në Kosovë.

Andaj, kërkoj votën tuaj “pro” ndëshkimit të atyre që bëjnë vepra të tilla. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Përpikuni që mos me u përsëritë shumë! Fjalën e ka kryetari i komisionit, deputeti Arben Gashi!

ARBEN GASHI: Falemnderit, kryetar!

Komisioni e ka trajtuar këtë amendament me seriozitet maksimal dhe nuk ia ka dhënë përkrahjen. Falemnderit!

KRYETARI: Armend Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Kryetar, me nenin 411 - veprimet e dhunshme janë mirë të specifikuara, prandaj e mbulon edhe këtë fushë, në çfarëdo vendi, në çfarëdo forme ku kryhet. Pavarësisht, që në të ardhmen mund të jetë një ligj i veçantë, i cili merret konkretisht, që lidhet me sportin dhe veprimet brenda objekteve sportive.

Prandaj, arsyeja pse ne nuk i kemi dhënë përkrahje është, se në konsultim edhe me prokurorin e shtetit, që ka qenë pjesëmarrës i Grupit Punues, nenet paraprake i mbulojnë këto vepra penale. Prandaj, nuk është e nevojshme, sepse krijohet një ambient apo një fokus i veçantë në objektet sportive ose konkretisht për sportin.

Pra, edhe kjo është arsyeja pse nuk i kemi dhënë përkrahje Komisioni FunkSIONAL.

KRYETARI: Pra, votojmë amendamentin 54, të deputetit Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Rezultati i votimit, është: 47 për, 29 kundër dhe 3 abstenime.

Shkojmë me amendamentin e 55-të, i propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e komisionit. Deputet, e ke fjalën!

BEKIM HAXHIU: Falemnderit, i nderuar kryetar!

Kam paraparë, domethënë këtu që nekrofilia të trajtohet si vepër e veçantë, domethënë, në Kodin e Ri penal duke pas parasysh që asnjë vepër, e cila nuk ndëshkohet me vepër penale, nuk mund të trajtohet si e tillë. Prandaj, mendoj që është e nevojshme, që ky amendament të ketë përkrahjen e komisionit dhe nekrofilia të trajtohet si vepër e veçantë penale. Falemnderit!

KRYETARI: Kryetari i komisionit?

ARBEN GASHI: Falemnderit, kryetar!

Komisioni e ka diskutuar me vëmendje këtë propozim dhe ka mbërri në konkluzionin se abuzimi me kufoma parashihet në vepra tjera penale dhe është vepër e rëndë penale dhe nuk ka nevojë të trajtohet si një akt i veçantë, i cili është propozuar, prandaj edhe nuk i ka dhënë përkrahje.

Ne mendojmë se është e paraparë shumë mirë në nenet tjera, kështu që specifikimi i tillë është i panevojshëm. Falemnderit!

KRYETARI: Besoj që edhe deputetët e kanë parasysh mendimin e Komisionit.

Tani, votojmë amendamentin 55.

(Ndërhyrje)

U krye, me 11 për, 36 kundër dhe 4 abstenime.

Votojmë amendamentin e 56-të!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet!

Amendamenti 57.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet!

Amendamenti 58.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet!

Dhe, në fund votojmë Kodin Penal, në tërësi! Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash!

Prezentë janë 90 deputetë.

Me 76 vota për, 9 kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Falemnderit!

Tash, vazhdojmë me pikën e radhës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për fshatin Hoqë e Madhe

Komisioni Parlamentar e ka shqyrtuar Projektligjin për fshatin Hoqë e Madhe dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, deputetin Nait Hasani, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime! Deputet, e ke fjalën!

NAIT HASANI: Falemnderit, kryetar!

Përsëndetje për kabinetin qeveritar!

Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin për fshatin Hoqë e Madhe dhe i ka prezantuar amendamentet në Kuvend dhe kërkojmë, që amendamentet e komisionit, të cilat komisioni në bashkëpunim me Qeverinë, me ICO-në, në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane dhe miqtë ndërkombëtarë, që jemi mësuar t'iu themi të gjithë, i ka bërë amendamentet.

Të gjitha amendamentet janë të pajtueshme, përveç amendamentit të Këshillit, ku Qeveria e ICO, nuk janë pajtuar.

Mendoj që ne kërkojmë si komision që amendamenti 5 i nenit 4, i komisionit të miratohet, sepse është konform Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 8 të saj, që Kosova është shtet laik.

Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështjet e besimeve fetare. Komisioni ka pas parasysh dhe ka kërkuar ta mbrojë Kushtetutën sepse Kushtetuta është edhe organi më i lartë i shtetit, të jetë ajo pjesë kryesore që ligji duhet të harmonizohet me Kushtetutën.

Nëse, në këtë aspekt kërkohet që të miratohet ligji, jo amendamenti i Komisionit FunkSIONAL, kjo tregon se me vetëdije deputetët, me vetëdije Qeveria detyrohen ta shkelin Kushtetutën.

Prandaj, kërkoj nga deputetët që t'i votojnë amendamentet e komisionit dhe ta mbrojnë Kushtetutën. Ju falemnderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar, deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Falemnderit, zoti kryetar!

Unë e desha fjalën që në fillim, për të bërë sqarimet që kam paraqitur një numër amendamentesh dhe për të evituar mundësinë e ngatërimit gjatë shqyrtimit.

Së pari, na është sjellë edhe një ligj, që mund të vlerësohet sfidues. Një ligj, që mund të thuhet se është edhe me sherr. Një ligj, që na vë para dy rreziqeve:

Një rrezik, që ta miratojmë ashtu siç është, nga dëshira për të dëshmuar fleksibilitetin e kooperativitetin dhe në këtë mënyrë të ngatërrojmë edhe më shumë çështjen. Të politizohet një çështje që s'duhet politizuar dhe praktikisht efektet të jenë kontraproduktive.

Dhe, rreziku tjetër që ta kundërshtojmë “an blok” dhe në këtë mënyrë të bimë në grackën tjetër, që t'u hapim gojën atyre që duan ta fajësojnë Kosovën e re “se ajo heziton për të respektuar të drejtat e njeriut, të drejtat e komuniteteve, të drejtat fetare”, e tjera!

Unë jam i bindur, që asnjëra as tjetra, nuk kanë bazë dhe as njëra as tjetra, nuk i duhen Kosovës.

Përpjekja ime për të bërë amendamente, ka qenë pikërisht për të evituar skajshmëritë, për të evituar këto dy rreziqe.

Këto dy ligje praktikisht janë të panevojshme. Dhe referenca te dokumenti i Ahtisarit është e shtrembëruar. Nuk është në rregull edhe të dogmatizohet dokumenti i Ahtisarit, por sidomos nuk është e lejueshme të shtrembërohet. Dokumenti i Ahtisarit ka paraparë rregullimin, ka paraparë zona të veçanta të mbrojtura dhe një ligj të veçantë për to, gjë që është miratuar nga ky Kuvend. Zonat e veçanta i ka themeluar ky ligj dhe jo të bëhet për çdo zonë nga një ligj. Do të na duheshin 50 e tepër, dhe përsëri do të kishim dis-balanc, sepse do të mbeteshin shumë të tjera.

Prandaj, nuk është kërkuar ligj i veçantë për Qendrën Historike të Prizrenit, as për fshatin Hoçë e Madhe.

Themelimi i zonave të veçanta të mbrojtura, në pajtim me nenin 4.1.7 propozimi gjithëpërfshirës i presidentit Ahtisari, është rregulluar me Ligjin për zonat e veçanta të mbrojtura.

Neni 8.2 i këtij ligji, me titull “Aktivitetet e kufizuara brenda zonave të veçanta të mbrojtura” ka paraparë, citoj “që aplikimi i nenit 6 të këtij ligji, për çdo aktivitet të ri në zonat e veçanta të mbrojtura, të përcaktohet me ligj, veni re: “të përcaktohet e të rregullohet me ligj”, “set fourth in low”, që thuhet. Do të thotë, të rregullohet me ligjet sektoriale dhe jo të bëhet ligj i veçantë.

Megjithatë, pa nevojë kemi hyr në këtë. Është kthyer në një obligim dhe që ka gjet vend në Raportin e Progresit. Dhe Kuvendi e ka miratuar në parim procedimin e këtyre ligjeve. Por e vërteta duhet thënë dhe duhet pasur parasysh, mirëpo duke qëndruar në përmbajtjen e këtij obligimi, do të thotë, të rregullohen vetëm aktivitetet e kufizuara në zonat e veçanta, që janë kryesisht të karakterit të planifikimit hapësinor.

Nuk është e rastit, që këto ligje janë dërguar Komisionit për Bujqësi dhe Planifikim Hapësinor. Çfarë logjike ka që Komisioni për Planifikim Hapësinor, të jetë kompetent për trashëgiminë kulturore e fetare? Nuk janë kompetentë. Por, është gjetur një deriçkë, për të futur këtu edhe një herë atë që është jo mbrojtje e monumenteve, e as e feve, por është politizim i tyre, tanimë i proklamuar edhe me pompë, si një pretendim për njëfarë protektorati fetar mbi Kosovën.

Kërkoj, zoti kryetar, që gjatë amendamenteve të shqyrtohen dhe t'më mundësohet që t'i shpjegoj edhe amendamentet e mia dhe dua vetëm një korrigjim: Në shumicën e rasteve është thënë, që amendamentet janë pa përkrahje nga komisioni. Ç'është e vërteta, shumica e tyre janë të inkorporuara në amendamentet e Komisionit dhe në to, natyrisht nëse mund të bëj vërejtje, unë mund të pajtohem. Por, ato me të cilat dallohem, amendamenti 1 dhe i ndonjë më vonë, mendoj që duhet t'më jepet mundësia për t'i sqaruar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Mundësia do të jetë e secilit propozues të amendamentit për ta sqaruar amendamentin e vet, por ju kisha lutur të na kurseni pak në kohë. Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu!

LIBURN ALIU: Falemnderit, zoti kryetar!

Unë pra, jam, e kam qenë pjesë e Komisionit dhe Grupit Punues në trajtimin e këtij ligji që nga fillimi e deri tash dhe të gjithë e dimë se nëpër çfarë fazash ka kaluar ky projektligj.

Ky projektligj ka pas shkelje të vazhdueshme dhe ka pas presione të vazhdueshme, por ajo që dua të them tani është kjo e fundit, e cila është kulmi i të gjithave. E për mua është dokumenti me amendamentet, që i mora dje nga një deputet, e që shumë deputetë e kanë këtu, ku amendamentet një për një secila e ka në kllapa (afër), se a duhet të votohet apo nuk duhet të votohet.

Ta zëmë, deputetit zoti Hydajet Hysenit i kisha thënë që të gjitha amendamentet e tij e kanë në kllapa nga një - jo. Disa nga amendamentet e kanë nga një - po, disa të tjera e kanë nga një - jo. Në ato amendamente, në të cilat komisioni ka bërë rezistencë në punën e tij të amendamentimit, te ato amendamente ka mbet: jo, pra nuk duhet të votohet.

Është bërë, dhe këtu i kemi amendamentet e Qeverisë, të cilat kanë ardhur si të paprekura. Në amendamentet e komisionit, që janë trajtuar, ka ardhur ICO-ja dhe kryeministri dhe në to pastaj ka pas debate e diskutime të ndryshme dhe ndryshim të amendamenteve të komisionit dhe aty ku është bërë rezistencë, tash deputetët e kanë mënyrën se si duhet të votojnë. Iu është treguar atyre të gjithëve, pra ku duhet me votua – po, e ku duhet jo, sepse do të mund eventualisht, të gabojnë.

Për sa i përket këtij projektligji, ky projektligj së pari është i papranueshëm, sepse trashëgiminë kulturore e shndërron në instrument të nacionalizmit dhe kjo është më e papranueshmja, sepse i thellon ndarjet në baza fetare dhe etnike, rrjedhimisht.

Ky trajtim i tillë ka sjellë probleme gjithmonë në Kosovë, e lufta dhe kudo në botë, po sidomos tek ne.

Problemi tjetër është që zonat e veçanta e kanë ligjin e vet, që është ligj i padrejtë prapë sepse në nenin e parë të tij është diskriminues. Këtu, tërë ato monumente kanë mund të mbulohen me zona të veçanta, po është dashtë edhe diçka tjetër. Është dashtë që fshatit me i dhënë kompetenca të veçanta, dhe atë kompetenca në fushën e planifikimit rural. Dhe, imagjinoni këtë, deri në çfarë pike kemi ardhur?! Thuhet: ta mbrojmë trashëgiminë kulturore, dhe në emër të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore i jepet kompetencë fshatit dhe i jepet kompetencë priftërinjve mbi trashëgiminë, që është në kundërshtim me çfarëdo rregulle botërore.

Në trashëgiminë kulturore, dhe kompetencë mbi të kanë vetëm institucionet profesionale, priftërinjtë, kishat, dhe ritet fetare mund të kryhen, sepse ato mund të jenë pronë dhe hapësira ku duhet të kryhen ritet fetare. Por, për sa i përket trashëgimisë dhe monumentit, aty ata nuk kanë të drejtë me prek, sepse e dëmtojnë.

Ngjashëm, e kemi rastin në Patrikanën e Pejës, e cila - pse ka qenë në kompetencën e priftit, është shkatërruar fasada e saj dhe është lyer me ngjyrë të kuqe.

Pra, edhe aspekti tjetër është pastaj. Planifikimi rural i fshatit prapë i jepet kompetencë nën një, i jepet kompetencë fshatit, që nuk do të duhej ta kishte dhe në fund - kur vjen puna te ankesat planifikimi rural i lehet në kompetencë KZM-së, e cila nuk ka kompetencë për planifikim rural, po për trashëgimi kulturore. Pra, këtu kemi defekte logjike, të cilat kanë kaluar dhe i kemi diskutuar shumë mirë në komision.

Me këto defekte, ka ardhur ky projektligj, kanë ardhur dhe amendamentet. Aty ku komisioni ka bërë përpjekje një grimë të bëjë një rezistencë, natyrisht tash është presioni tjetër, i fundit, që edhe aty nuk duhet të votohen ato amendamente të komisionit.

Unë do ta jap mendimin tim, në secilin amendament veç e veç. Mendoj se ka edhe shkelje të rregulloreve botërore, për sa i përket trashëgimisë. Shembull konkret, këtu quhet: trashëgimi fetare, nuk ka trashëgimi fetare. Ka trashëgimi kulturore. Nuk është një monument fetar, trashëgimi fetare. Ai është trashëgimi kulturore. Nëse është ndërtuar në shekullin e 14-të, 15-të ai e tregon kulturën e një populli, i cili e ka ndërtuar me mjetet e veta në atë kohë, në nivelin e kulturës së tij. Nuk është feja trashëgimi. Feja është e pandryshueshme dhe monumentet që prodhohen, të motivuara nga feja, janë trashëgimi kulturore.

Të gjitha këto defekte të shumta, çojnë kah ajo që në fshatra të mund të krijohet një presedan, ku secili fshat mund të kërkojë pastaj kompetenca të veçanta për sa i përket planifikimit rural, sepse u tejkaloa trashëgimia kulturore. Tash mund cilido fshat me u çue e me thënë: Edhe unë po dua me pas kompetenca të veçanta, për sa i përket planifikimit rural, edhe pse nuk kam ndonjë monument brenda zonës ku jam! Prandaj, ky ligj është totalisht i papranueshëm.

KRYETARI: Deputetë, mendimin e kundërt dhe përpjekjet me të ndihmu, s'duhet me i marrë si presion. Deputeti Daut Haradinaj, e ka fjalën!

DAUT HARADINAJ: Falemnderit, kryetar!

KRYETARI: Ju kisha lutur, t'i përmbledhni pak më shkurtë mendimet!

DAUT HARADINAJ: Është shumë e vërtetë që ky ligj nuk është që ne e kemi kërkuar, ka qenë me prejardhje nga pakoja e Ahtisarit, dhe natyrisht se kemi pas shumë probleme e shumë telashe. Është e vërtetë, kryetar, që na kanë ndihmuar shumë miqtë.

Por, ajo që desha me thënë, është shqetësimi im e mendoj edhe i deputetëve dhe shpresoj që do ta kemi mirëkuptimin e tyre. Te amendamenti 5, shpresoj që do t'i marrim votat në përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, sepse mendoj që materia kryesore ose baza kryesore e kontestit të këtij ligji është pikërisht amendamenti 5, për shkak se aty përcaktohet se kush e ka kompetencën në nivel lokal.

Në rast se nuk i kalon në kompetencë komunës, domethënë, në rast se komuna nuk e ka përgjegjësinë për me udhëheq ose për me organizua edhe funksionimin edhe implementimin e këtij ligji, atëherë ky ligj është "inekzistent" ose i pavlefshëm. Dhe, shpresoj që deputetët do ta kenë mirëkuptimin dhe do t'i japin mbështetje Komisionit FunkSIONAL në amendamentin 5. Ju falemnderit!

KRYETARI: Ju falemnderit, deputet! Deputeti Salih Morina, e ka fjalën!

SALIH MORINA: Falemnderit, kryetar!

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, e ka dhënë kontributin e vet edhe në leximin e dytë, si anëtarë të Komisionit. Me që ky ligj tashmë edhe ka marrë karakter politik dhe njëkohësisht i prekë disa nene dhe disa amendamente që edhe e shkelin Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike do të votojmë kundër këtij projektligji edhe në leximin e dytë. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit Deputeti Muhamet Mustafa, e ka fjalën!

MUHAMET MUSTAFA: Unë dëshiroj të falënderoj Komisionin dhe kryetarin e Komisionit, për një punë shumë të durueshme, që e kanë bërë, e të na e sjellin një draft të ligjit, i cili në shumë pika e ka përmirësuar ligjin.

Prandaj, unë ftoj edhe deputetët tjerë që të angazhohemi e të gjejmë zgjidhjet më të mira rreth këtij ligji, sepse është shumë delikat dhe duhet të votojmë me përgjegjësi.

Ajo që edhe mua më bën shumë të brengosur sot është kjo forma qysh i kemi marrë amendamentet me - po dhe jo. Ne duhet ta dimë kush është autor i këtyre – po dhe - jo, në këtë letër që kemi marrë këtu. Sepse, kjo është e pazakonshme dhe është fyese për

deputetët. Dhe, kërkoj sqarim nga Administrata e Kuvendit. Kush është autor i këtyre - po dhe – jo.

Sa më përket mua personalisht, unë do t'i injoroj tërësisht ato - po dhe jo, dhe do të votoj sipas ndërgjegjes sime dhe i lus të gjithë deputetët, të vijnë ashtu. Por, gjithashtu kërkoj që kjo të mos përsëritet asnjëherë më, se ne jemi këtu të thirrur me votua sipas ndërgjegjes sonë dhe sipas përgjegjësisë sonë edhe për krijimin e një Kosove tolerante e prosperuese, por jo që deputetët të jenë këtu vegla dhe të votohet ashtu qysh u thuhet nga dikush.

Nuk duhet të nënçmohet intelijenca jonë, që me përgjegjësi të votojmë edhe për integritetin e Kosovës, edhe marrëdhëniet ndëretnike, edhe përgjegjësinë ndaj Bashkësisë Ndërkombëtare dhe miqve tanë. Prandaj, ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Falemnderit, deputet! Ata që i kanë ato materiale, le t'i pyesin shefat e grupeve parlamentare. Nuk janë pjesë e administratës. Prandaj, duhet të jemi aty ku jemi. Fjalën e ka deputetja Alma Lama, po mundësisht shkurt Alma. Mos të zgjasim shumë.

ALMA LAMA: Shumë, shumë shkurt, zoti kryetar.

Unë vetëm desha t'ia uroj Kuvendit të Kosovës miratimin e shtetit diktatorial, që e vulosi sot me miratimin e nenit 37 dhe 38 të Kodit penal, që shantazhon dhe burgos gazetarët.

Tani me këtë Ligj për Prizrenin, po u miratua, ju uroj edhe vulosjen e serbizimit të Kosovës. Falemnderit!

KRYETARI: Jo, shumë është kjo, çka keni thënë! Shumë është, shumë është! Fjalën e ka kryeministri, zoti Hashim Thaçi!

KRYEMINISTRI, HASHIM THAÇI: Falemnderit, i nderuari kryetar Krasniqi!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke iu falënderuar të gjithë ju deputetë të nderuar për punën serioze që e keni bërë në kuadër të komisioneve parlamentare për përpilimin e amendamenteve për Ligjin për Prizrenin dhe atë të Hoçës së Madhe, më lejoni, në emër të Qeverisë, që të theksoj disa gjëra të rëndësishme, të cilat mendoj se duhet t'i merrni në konsideratë para se të hyni në procesin e votimit.

Unë si kryeministër dhe ju si deputetë të zgjedhur, kemi përgjegjësi të jashtëzakonshme përpara qytetarëve të Kosovës, përpara institucioneve shtetërore, përpara komunitetit ndërkombëtar, obligimeve ndërkombëtare dhe mbi të gjitha mbajmë përgjegjësi për të ardhmen tonë.

Në këtë aspekt, ne bashkërisht deri më tani kemi bërë shumë punë të rëndësishme dhe kemi arritur që vizionin tonë për Kosovën demokratike, të pavarur e shumetnike ta bëjmë

realitet. Këtë realitet e kemi ndërtuar duke punuar së bashku pozitë dhe opozitë, me një koordinim të ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare.

I gjithë ky projekt është ndërtuar duke u bazuar në propozimin gjithëpërfshirës të presidentit Ahtisari dhe siç e dimë këtë dokument thelbësor e kemi pranuar dhe votuar të gjithë në Parlament dhe e kemi bërë veprimin më të duhur, sepse kështu kemi siguruar shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, kemi siguruar njohjen ndërkombëtare, kemi siguruar anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare dhe mbi të gjitha i kemi siguruar të gjitha komunitetet, që të jetojnë në Kosovë dhe të trajtohen si të barabartë me respektimin afirmativ të të drejtave të tyre, në veçanti të komunitetit serb, sa i përket edhe gjuhës, religjionit, trashëgimisë kulturore, që do të ruhet dhe respektohet në mënyrë institucionale.

Deputetë të nderuar,

Zonja dhe zotërinj,

ju të gjithë jeni deputetë dhe këtu përfaqësojmë parti politike të ndryshme, të cilat kanë edhe interesa dhe qëllime të ndryshme politike. Por, gjithmonë na ka bashkuar interesi i shtetit dhe interesi i të gjithë qytetarëve, pa dallime partie apo etnie. Mirëpo, unë jam i sigurt se të gjithë ju e doni Kosovën dhe dëshironi që shteti ynë të jetë shtet serioz, të përparojë dhe mbi të gjitha t'i kryejë detyrimet e veta në raport me obligimet që kemi ndërmarrë edhe në raport me bashkësinë ndërkombëtare.

Ju jeni në dijeni se këtë vit, bashkërisht kemi filluar miratimin e ligjeve të fundit që burojnë nga pakoja e Ahtisarit. Dhe, duke e përmbyllur një proces të tillë, ne sigurohemi që t'i japim fund fazës së mbikëqyrjes së Pavarësisë së Kosovës nga bashkësia ndërkombëtare, saktësisht nga Zyra Ndërkombëtare Civile.

Ky moment duhet të merret shumë seriozisht, sepse paraqet një moment tjetër historik për Kosovën. Është momenti, kur Kosova dëshmon para botës demokratike se ne jemi të konsoliduar si shtet, si institucione, si qytetarë që vazhdojmë rrugëtimin tonë, tërësisht të pavarur.

Ky moment dëshmon, se shoqëria jonë nuk rrezikohet që të kthehet në të kaluarën e hidhur, jo të largët.

Deputetë të nderuar,

Zonja dhe zotërinj,

Komisioni Funkcional dhe deputetët, në kuadër të këtij komisioni e kanë bërë një punë të mirë. Dhe, ndjehem mirë që bashkërisht kemi punuar në komision dhe kemi krijuar hapësirë e rrethana lehtësuese që të kemi një koordinim më të mirë dhe orientim edhe më të qartë.

Komisioni ka dhënë shumë rekomandime të dobishme, të cilat me siguri se do të votohen nga ju sot. Mirëpo kanë dhënë edhe propozime për amendamente, të cilat bien ndesh me planin gjithëpërfshirës të Ahtisarit.

Unë dua të sqaroj, se në rast se votohet, dëshiroj të jem shumë i qartë, të nderuar deputetë, se në rast se votohet qoftë edhe një amendament i tillë i cili është në kundërshtim me pakon e Ahtisarit, atëherë të dyja këto ligje bëhen të pavlefshme dhe nuk do t'i shërbejnë askujt.

Për më tepër, miratimi i amendamenteve që bie ndesh me pakon e Ahtisarit, hap dilema të mëdha për proceset në vazhdim.

Prandaj, dua të ju ftoj që të jemi të gjithë të përgjegjshëm dhe të vëmendshëm, me qëllim që të votojmë ligjet duke ruajtur frymën dhe dispozitat, të cilat janë në përputhje me pakon e Ahtisarit.

Deputetë të nderuar,

Edhe njëherë dua ta ritheksoj rëndësinë e madhe që këto ligje kanë për tu miratuar, bazuar në dispozitat që parasheh pakoja e Ahtisarit, sepse në të kundërtën ato do të jenë krejtësisht të padobishme.

Unë dua të besoj se të gjithë deputetë, si ju të pozitës por dhe të opozitës, e keni të qartë rëndësinë e votimit të këtyre dy ligjeve.

Përmbyllja e mbikëqyrjes së Pavarësisë së Kosovës nuk ndërlidhet vetëm me Qeverinë, nuk ndërlidhet vetëm me një parti, por është në interesin e shtetit të Kosovës, të gjitha partive politike, të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, është zotim yni i përbashkët, që të përmbylim mbikëqyrjen me sukses.

Po ashtu, e keni shumë të qartë se cilat amendamente të propozuara janë të pranueshme dhe të dobishme dhe cilat amendamente janë të papranueshme, për shkak se bien ndesh me Pakon e Ahtisarit.

Dëshiroj të ju ftoj për maturi politike, duke ju ftuar që të jemi të bashkuar në qëllimin tonë për dhënien fund të pavarësisë së mbikëqyrur, e cila pastaj hap një kapitull të ri të shtetit tonë të pavarur - atë të integritetit. Prandaj, ftoj të gjithë deputetët, pa dallime partie, pa dallime etnie, për miratimin e këtyre ligjeve, që janë jashtëzakonisht të rëndësishme, për ne.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, përmbylljen e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, që është planifikuar të ndodhë në shtator e kemi në vullnetin dhe duart tona tani, me votimin tonë dhe vendoset në këto momente. Natyrisht, dua të jem shumë i hapur dhe i sqartë – përmbyllja e mbikëqyrjes së pavarësisë i ka edhe kundërshtarët e vet, prandaj ky zotim, kjo vendosmëri e Kuvendit të Kosovës, e institucioneve të Kosovës për përmbylljen e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës është e koordinuar me të gjithë miqtë dhe partnerët që na kanë ndihmuar edhe për çlirimin e vendit, edhe për bërjen e Kosovës së pavarur dhe që na mbështesin në procesin e integritetit të Kosovës në NATO dhe Bashkim Evropian.

Sot, të gjithë miqtë dhe bora demokratike nga ne pret vendosmëri dhe qartësi, dhe në asnjë rrethanë dilemë. Prandaj ju ftoj të gjithëve që t'i votoni amendamentet plotësisht që janë në përputhshmëri me dokumentin e presidentit Ahtisari. Faleminderit shumë, edhe një herë.

KRYETARI: Diskutimet përfunduan! Do të thotë ligjet dhe amendamentet i kemi përpara. Po shkojmë sipas radhës.

Fillojmë me amendamentin 1, i propozuar nga deputeti Hydajet Hyseni, pa përkrahje e Komisionit funksional. Deputet, mund ta arsyetosh amendamentin!

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, kryetar!

Në mua, nuk ka bërë askush presion. Madje as atë letrën me po, jo – s'e kam marrë. Po nuk jam më pak i motivuar se cilido nga parafolësit për imazhin e Kosovës dhe jo vetëm për imazhin por edhe për realitetin që duhet të jetë dinjitoz dhe që dëshmohet edhe në qëndrimin ndaj komuniteteve pakicë, ndaj trashëgimisë kulturore, ndaj të drejtave të tyre dhe mendoj që kjo dilemë duhet të hiqet fare. I gjithë ky Kuvend, unë besoj se është në këtë linjë. Le të mos i imputohet diçka që nuk e ka.

Por, pikërisht për të qenë në harmoni me edhe shkronjën e dokumentit të Ahtisarit, unë nuk jam për dogmatizmin e tij, nuk është ai Bibël, por megjithatë nëse thirremi te ai, ky dokument nuk kërkon ligj të veçantë për Hoqën e Madhe dhe as për Prizrenin. Kërkon Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura që disa çështje e aktivitete të kufizuara.....

KRYETARI: Hydajet, të lutem për amendamentin, se ne i diskutuam ato tjerat.

HYDAJET HYSENI: Jo, amendamenti është! Të lutem! Po e arsyetoj amendamentin tim, kryetar!

... kërkon që aktivitetet e veçanta të rregullohen në Ligj. Prandaj, edhe propozimi im, të nderuar deputetë e i nderuar kryetar, është që titulli të jetë në përputhje me shkronjën e dokumentit të Ahtisarit - "Ligj për aktivitetet e kufizuara në zonën e veçantë Hoqa e Madhe".

Dhe me këtë, ne evitojmë kazus-belin që prodhon pastaj të gjithë situatën brenda tij. Ne e miratojmë një ligj sipas kërkesës, edhe pse është më shumë se që është kërkuar, por nuk hyjmë në çështje që kanë të bëjnë me raportet e pushteteve, me raportet e feve, me trashëgiminë kulturore që objektivisht nuk mund të rregullohet me një ligj për një fshat. Prandaj, propozimi im, kërkoj që të merret në konsideratë dhe të krahasohet. E keni dokumentin e Ahtisarit, është pikë për presë në përputhje me shkronjën e tij.

Do të dëshiroja për ata që mund të kenë mendim ndryshe, të kemi rast për debat e për ballafaqim, qofshin ata edhe miqtë tanë.

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit? Nuk ke çka të thuash!

(Ndërhyrje)

Po ua lë deputetëve të vendosin! Kërkoj nga deputetët dhe regjia, të përgatiten për votim, dhe votojmë... Po urdhëro bre Liburn Aliu!

LIBURN ALIU: Amendamenti i propozuar nga deputeti Hydajet Hyseni është e vërtetë se është amendament që i përmbahet pakos së Ahtisarit. Pra, në përgjithësi amendamentet e deputetit Hydajet Hyseni janë brenda pakos së Ahtisarit.

Ne si Lëvizje, nuk e pranojmë sepse është e pakos së Ahtisarit. Po, përndryshe, amendamenti i cili është aktualisht, nëse ky nuk kalon, është përtej pakos së Ahtisarit.

Ne do të votojmë kundër, sepse jemi kundër pakos. Po kjo, është brenda pakos. Nëse thirremi në pako, kjo është brenda pakos.

(Reagime)

Po, edhe pakoja është e keqe.

KRYETARI: Dakord, por krejt këtu jemi brenda pakos! Në rregull, faleminderit! Amendamenti është i propozuar nga Hydajet Hyseni, por nuk e ka mbështetjen e komisionit funksional. Prandaj, ne po shkojmë në votim.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. E votojmë amendamentin 1 dhe votojmë tash:

Me 3 vota për, 69 kundër dhe 26 abstenime, nuk kalon amendamenti 1.

Amendamenti 2.

A ka kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Reagim)

Mirë, unë po e marrë atë që e thatë ju. Është vetëm një amendament dhe shkojmë në votim.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten votim dhe votojmë tash amendamentin 2.

Me 65 vota për, 9 kundër dhe 21 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3. I ka dy propozime:

- Propozimi i Komisionit funksional;
- Propozimi i deputetit Hydajet Hyseni.

Hydajet, nëse do, mund ta arsyetosh amendamentin?

HYDAJET HYSENI: Duhet të ju falënderoj prapë për mundësinë, sado që nuk besoj se do të kuptohem. Ndoshta edhe s'po di ta sqaroj.

Këtu e kam një vërejtje që është formale dhe mund edhe të bënte edhe pa të, por në gjuhën serbe ka një dallim shprehja “opseg prava sela” që në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe është “e drejta e fshatit”. Kërkoj vetëm që të harmonizohen këto. Do të thotë, sipas një praktike që e kemi pasur, në raste të tilla është marrë versionin anglisht, që është “e drejta e fshatit”, por jo “spektri i të drejtave të fshatit” që krijon mundësi pastaj edhe të interpretimit ekstensiv e abuziv.

Besoj se votimi nuk shpreh ndërgjegjen, por shpreh edhe mos informimin.

KRYETARI: Edhe gatishmërinë, për të votuar! Liburn, e keni fjalën!

LIBURN ALIU: Prapë, ky përkufizim është sipas pakos, ndërsa për propozimin e parë të Komisionit funksional, edhe pse përkufizimi është mjaft i rregullt, problemi qëndron në faktin që quhet trashëgimi fetare. Ky është gabim në nocion dhe kjo bën që ne ta votojmë kundër.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Shkojmë në votimin e amendamentit 3, propozimin e parë të Komisionit funksional, dhe votojmë tash:

Me 66 vota për, 11 kundër dhe 21 abstenime, miratohet amendamenti 3 i Komisionit funksional.

Amendamenti 4 i ka tri propozime:

- Propozimi i Komisionit funksional;
- Propozimi i Qeverisë, pa përkrahjen e Komisionit funksional, dhe
- Propozimi i deputetit Hydajet Hyseni, me përkrahjen e Komisionit funksional.

Tash e kanë të drejtën, edhe Hydajeti, edhe Qeveria ta bëjnë arsyetimin. Po fillojmë me deputetin Hydajet Hyseni.

(Ndërhyrje)

Atëherë, po shkojmë te Komisioni funksional. Deputeti Nait Hasani, e ka fjalën!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni e ka shqyrtuar amendamentin, nenin 3 pika 10 të fjala “komitet” ku është pajtuar edhe Ministria për këtë. Dhe një propozim i tillë ka ardhur edhe prej Hydajetit, kështu që ky amendament e ka përkrahjen edhe të Hydajet Hysenit dhe të Ministrisë. Është një amendament i përbashkët, pra edhe i Komisionit.

KRYETARI: Nga Qeveria, kush e do fjalën? Urdhëro, ministër!

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Deputetë të nderuar,

Ashtu siç e përmendi më herët edhe kryetari i Komisionit, edhe kryeministri, Qeveria bashkë me Komisionin ka punuar me muaj të tërë që të harmonizohen pikat e këtij ligji, domethënë të amendamenteve të ndryshme. Prej 15 amendamenteve që i ka propozuar Komisioni, i kemi harmonizuar deri në një pikë, do të thotë në pikën vijuese e cila vjen pas këtij amendamenti, që është ajo pikë e cila është në kundërshtim të plotë me pakon e Ahtisarit.

Sa i përket këtij amendamenti, Qeveria tërhiqet në favor të amendamentit të Komisionit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Liburn, e ke fjalën!

LIBURN ALIU: Këtu pra, është arritur një kompromis në Komision, por kompromisi prapë është i papranueshëm sepse Ligji i referohet zonave të veçanta të mbrojtura, e Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura në nenin e parë të tij, është ligj diskriminues. Prandaj, edhe është i pa pranueshëm!

KRYETARI: Atëherë vazhdojmë me votimin e amendamentit 4, propozimin e Komisionit funksional dhe votojmë tash:

Me 68 vota për, 10 kundër dhe 20 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Tani vazhdojmë me amendamentin 5, që i ka tri propozime:

- Propozimi i Komisioni funksional;
- Propozimi i Qeverisë, pa përkrahjen e Komisionit funksional, dhe
- Propozimi i deputetit Hydajet Hyseni, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Hydajet, ti e ke përparësinë për të arsyetuar i pari.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit!

Pak përpara miratuam një amendament, do të thotë e kundërshtuam një amendament që harmonizon gjuhën shqipe me gjuhën angleze, me gjuhën serbe. Do të thotë, vetëm që të jemi të informuar se Kuvendi i miratoi dy variante në një shprehje.

Uroj që të zbatohet në praktikë mirë dhe të rregullohet në procesin e standardizimit.

Po në këtë amendament, së pari fjala “përfaqëson” kam propozuar të zëvendësohet me shprehjen “kujdeset për”, sepse nuk mund një përfaqësim i një segmenti të caktuar të krijojë mundësinë e kuptimit që e përjashton përfaqësimin institucional të të zgjedhurve të atyre lokaliteteve.

Vërejtja e dytë, është përfshirë. Dhe vërejtja tjetër, që ka mbet në variantin e Qeverisë dhe mendoj se duhet të korrigjohet dhe është në përputhje me dokumentin e Ahtisarit, emërtimi “kisha ortodokse serbe” kërkohet me amendamentin tim, që edhe Komisioni ka

qenë dakord, t'i shtohet “në Hoqë të Madhe” për të evituar mundësinë e politizimit dhe për t'u kuptuar sikur ka të bëjë me nivele që objektivisht do t'ishhin jofunksionale. Ka të bëjë me Kishën ortodokse serbe në Hoqë të Madhe dhe në dokumentin e Ahtisarit, në pjesën më të madhe kur përdoret emërtimi “kisha ortodokse serbe” të thuhet edhe “në Kosovë”. Dhe mendoj që kjo është në përputhje edhe me kushtet tona, edhe në favor të depolitizimit të çështjes. Unë pres që së paku, këto të miratohen.

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit, deputeti Nait Hasani!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Amendamenti 5 i Komisionit është në përputhje me Kushtetutën, në përputhje me paketën e Ahtisarit. Është një përbërje që e ka kërkuar edhe Ministria, të rritet numri nga 5 në 7 dhe është kërkuar që pikërisht t'i përfshijë, sepse mos të shkelë Kushtetutën. Unë e mora edhe Kushtetutën këtu, që e kam marrë më të madhe për me mund me pa se çka shkruan. Pra, është që mos ta shkelim Kushtetutën dhe kërkoj që të respektohet neni 8 i saj. Përndryshe jemi të detyruar që për shkelje të Kushtetutës për shkak të këtij amendamenti, ta çojmë lëndën në Gjykatë Kushtetuese. Prandaj, respektoni Kushtetutën. Pra, kërkoj nga deputetët që ta respektojnë Kushtetutën sepse vetë e thatë më herët, jemi në bazë të pakos, dhe në bazë të Kushtetutës në Kuvend.

KRYETARI: Faleminderit Nait për komplimentin! Qeveria e ka fjalën. Ministër, Gashi!

MINISTRI DARDAN GASHI: Fillimisht, do të thotë, Qeveria tërhiqet nga amendamenti i saj, por disa sqarime, për hir të opinionit.

Nuk është aspak e vërtetë që kjo bie ndesh me Kushtetutën. Kisha ortodokse serbe në Hoqë të Madhe nuk përfaqësohet në këtë komision. Kisha ortodokse serbe në Hoqën e Madhe e emëron, si të them, kushtimisht – një avokat, një banorë të Hoqës së Madhe që t'i përfaqësojë interesat e kishës në atë komision. Ky Komision, apo në të vërtetë Këshill, siç jemi dakorduar ta quajmë, ka vetëm rol këshillëdhënës, nuk ka rol ekzekutiv. Pra, rrjedhimisht nuk mund të ketë as kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk e di se prej nga ideja që Qeveria e Republikës së Kosovës do të sjellë në këtë Kuvend ligje të cilat bien ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Prandaj, Qeveria tërhiqet nga amendamenti i saj, në favor të versionit të leximit të parë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Nait Hasani, shkurt!

NAIT HASANI: Faleminderit!

Këtu ministri u shpreh në mënyrë vullgare. Për mua është fyese kur thuhet, është e pavërtetë. Do të thotë, dikush po rrenë këtu. Të lutem, kryetar!

KRYETARI: Regjia, ia mundësoni të flet deputeti Nait Hasani!

NAIT HASANI: Ministri, u shpreh në mënyrë vullgare dhe e tha një të pa vërtetë, sepse po ashtu Ministria ka ardhur me propozimin e vet, dhe pse nuk i ka kaluar propozimi,

tash tërhiqet dhe tërhiqet në favor të leximit të parë të Ligjit, që është shumë i dëmshëm, sepse këtu e kemi drejtpërdrejt shkeljen e Kushtetutës.

Unë nuk them që Qeveria i bie ligjet që e shkelin, por këtë ligj e ka prurë me imponim për shkeljen e Kushtetutës. Domethënë, ky amendament – ky paragraf e bën shkeljen e Kushtetutës. Juristët që i kemi pasur, që na kanë ndihmuar, ata thonë se kjo është shkelje e Kushtetutës.

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Deputet, po kërkoj që edhe deputetët edhe ministrat të kursehen nga fjalët jo parlamentare.

(Ndërhyrje)

Po, edhe ministrat edhe deputetët! Tash shkojmë në votim të amendamentit.

(Ndërhyrje)

Shiko! E tha kryetari i Komisionit dhe nuk di çka kemi të themi më. Ti s'po e pranon pakon, burrë! Mirë, urdhëro, por shkurt, të lutem Liburn...

LIBURN ALIU: Nuk është edhe aq shkurt!

Së pari, në propozimin e Komisionit funksional, kur bëhet fjalë për këshillin e fshatit, Komisioni ka propozuar që të jenë 4 anëtarë nga komuna dhe 3 anëtarë nga fshati. Nuk e ka paragjykuar etninë e përfaqësuesve nga komuna. Nuk e ka paragjykuar prejardhjen, se të kahit mund të jenë. Ata mund të jenë punëtorë të komunës dhe të Hoqës dhe të jenë në këshill si përfaqësues të komunës. Pra, në këtë aspekt nuk është paragjykuar fare. Nuk paragjykohet as etnia, as vendi, e adresa e tyre prej nga vijnë.

Ku është problemi te ky amendament, nëse nuk kalon ky, dhe i mbetet shumica fshatit? Së pari, trashëgimia kulturore, po i mbetet në kompetencë fshatit. Fshati po ka kompetencë mbi trashëgiminë kulturore, mbi komunën. Dhe, në këtë rast ai e çon adresën te KZM-ëja. Dhe, më i rëndë është fakti që fshatit po i lihet kompetencë në planifikim rural. Për fshatin nuk mund të paragjykohet që kanë dije për sa i përket planifikimit rural. Dhe, nëse bie ndesh me komunën, në lidhje me planin zhvillimor të fshatit, atëherë ankesa shkon në KZM. E KZM-ëja nuk ka kompetencë fare për planifikim rural.

T'i kthehem edhe një herë çështjes. Nëse një iniciativë për planifikim rural nga fshati kalon dhe është në kundërshtim me planin zhvillimor të komunës, për këtë çështje ankesa shkon në KZM e KZM nuk ka fare kompetencë e as dije për sa i përket planifikimit rural. Prandaj, logjikisht këtu nuk qëndron ky amendament i Qeverisë. Është e domosdoshme pra të amendamentohet amendamenti i Komisionit.

E tash, për sa i përket kundërshtimit me pakon e Ahtisarit, unë nuk ka mund me gjet kurrkund në pakon e Ahtisarit që thuhet duhet fshati me i pas 4 anëtarë ose më pak. Thuhet, "autoritet i kufizuar". Pra, kjo është përtej pakos së Ahtisarit. Autoritet i kufizuar, le të jenë 3 anëtarë. Është shumë e qartë.

Nëse ky amendament kalon, keni me pas defekt në fushën e planifikimit rural dhe nuk kemi asnjëfarë diskriminimi këtu, nuk kemi asnjëfarë shkelje as kundrejt pakos e këtyre gjërave. Prandaj, ky amendament i Komisionit duhet të votohet dhe nëse nuk votohet ky amendament atëherë totalisht ligji do të jetë katastrofal.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Daut Haradinaj, e ka fjalën!

DAUT HARADINAJ: Veç po dua me e falënderuar Liburnin për kontributin e madh që e ka dhënë në ligj, fillimisht. Dhe po dua me e siguruar që edhe Ligji për Hoqën s'ka me e kthye Serbinë në Kosovë, mos ta ndien!

Propozimi i Komisionit funksional, është me kanë 7 anëtarë. 4 nga komuna e Rahovecit, që nuk e përcakton etninë dhe 3 nga fshati. Propozimi i Qeverisë është po ashtu prej 7 anëtarëve, 3 nga komuna, 3 nga fshati Hoqë dhe 1 nga kisha ortodokse serbe.

Zoti ministër, këtu e bëre një gabim, se nuk është e saktësuar që kisha ortodokse serbe për çka është kah follet. Domethënë, ky është edhe defekti. Komisioni po thotë, që nëse nuk e përcakton ose nuk e paragjykon etninë në rast se komuna, ta marrim shembull, mund ta delegojë një që nuk është i përkatësisë etnike shqiptare, mundet me qenë diçka tjetër. Mundet me i çua dy-tre. Dhe ne, krejt çka po kërkojmë është që t'i jepet rrugë, t'i jepet kahe.

Në rast se ky propozim i Komisionit nuk kalon, unë ju siguroj që ky ligj, edhe efektin ka me e humbë. Sepse, do t'i komplikoni të gjitha procedurat e mundshme për me u implementuar ky ligj, sepse drejtpërsëdrejti përgjegjësi e komunës është, edhe emërimi i Këshillit, edhe organizimi i zgjedhjeve, se e keni pa dhe e keni në afatin kohor.

Domethënë, krejt çka po kërkojmë është që t'i jepet drejtim këtij ligji. Komisioni ka propozuar që të shkohet me 4 anëtarë nga komuna, 3 nga fshati. Prej 3 nga fshati, mund të jetë 1 i kishës ortodokse serbe në Hoqë, nu ke pengon kurrkush. Mund të jetë po ashtu i përkatësisë etnike serbe që është i deleguar nga kryetari i komunës.

Domethënë, ne çka po flasim sot, është që t'i japim orientim drejt këtij ligji, sepse të gjithë po domi me e kaluar.

Po dua me e siguruar edhe opinionin publik, sepse po bëhet marketing pak me opinionin. Për këtë ligj kemi bashkëpunuar të gjithë bashkë, në mesin e tyre shumë aktivë ka qenë edhe zoti Liburn Aliu, që e ka dhënë një kontribut të madh dhe e falënderoj shumë, por të njëjtën kohë nuk duhet tashti me na shit fort patriotizëm, për shkak se në momente të caktuara, kur ka ardhur në pyetje me votuar, ju Liburn, e keni lëshuar sallën dhe e keni lënë vetëm një deputet të opozitës me votuar kundër.

Këtë duhet me ia sqaruar opinionit. Dhe, ju kam thënë edhe një herë tjetër se nuk është e drejtë. Dhe, në rast se ju kishit ndej në sallë, dhe në rast se ne opozita ishim bë bashkë, kishim votuar kundër, ju siguroj që as kryeministri me pjesëmarrjen e vet që na ka

nderuar shumë e ndihmuar, as Pieter Feith me pjesëmarrjen e vet, dhe as miqtë tjerë që kanë marrë pjesë – nuk kishin mund me e kaluar ligjin. Por, në momentin kur ka ardhur te votimi, ju e keni braktisur sallën.

Ky ka qenë një gabim, mendoj dhe shpresoj se në të ardhmen nuk do të përsëritet dhe uroj që nuk e lëshon sallën sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jo, nuk kemi këtu debat të mirëfilltë! Por, megjithatë, po i japim mundësi secilit grup parlamentar një herë me e thënë mendimin e vet dhe unë mendoj se kjo është e mjaftueshme.

(Ndërhyrje)

Jo, nuk ka nevojë. O Liburn, nuk ka nevojë bre! Atëherë, e merrni vetëm për një minutë, replikë! Kërkoj nga regjia, të mos ketë më shumë se dy minuta, për asnjë diskutues, përveç prezantuesit të amendamentit.

LIBURN ALIU: Gjatë votimit të këtyre amendamenteve, unë kam qenë për. Dhe kur është votuar ky amendament, unë kam qenë aty, dhe në të gjitha votimet tjera.

Ju e dini shumë mirë, pauzën të cilën e ka caktuar kryeministri Hashim Thaçi dhe e ka caktuar gjysmë ore, dhe të gjithë jeni kthyer brenda 15 minutave dhe i keni votuar tjerat. Pra, ju i keni votuar të gjitha rend.

Për këtë, kam qenë pikërisht unë sikur edhe sot, që jam kundër. Dhe, në amendamentin 15. Në të gjitha tjerat ju keni lëshuar pe, një nga një, dhe në fund doni kalanë e fundit me thënë e kemi këtë. Dhe këtë nuk mundesh me e mbrojt, nëse nuk i ke mbrojtur pikat tjera rend.

Për sa i përket Ligjit të Prizrenit, prej fillimit deri në fund, e kam lëshuar sepse ka pasur shkelje prej fillimit deri në fund.

KRYETARI: Faleminderit! Daut, mendoj se e the, dhe ne dëgjuam çka the. S'besoj që ke diçka të re! Hajt, urdhëro! Daut Haradinaj e ka fjalën!

DAUT HARADINAJ: E sugjeroj Liburnin, me shkue me e marrë transkriptin dhe me e lexuar se ajo është në transkript.

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI DARDAN GASHI: Pajtohem plotësisht me zotin Haradinaj, se Ligji duhet të jetë funksional, dhe për këtë arsye edhe një herë e mora fjalën. Do të thotë, nëse ky amendament i Komisionit funksional kalon, atëherë është në kundërshtim me pakon e Ahtisarit, është në pengim të procesit të përmbylljes së pavarësisë së mbikëqyrur, kështu që edhe Qeveria u tërheq prej amendamentit të vet dhe sugjeroj dhe ju lus që të mos votohet amendamenti i Komisionit.

KRYETARI: Ju lutem, të nderuar deputetë! I dëgjuat të gjitha palët. Urdhëro, kryeministër, por mendoj se e kanë të qartë deputetët.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Pasi që ndodhën debate të ndryshme edhe në mes anëtarëve të Komisionit për qartësi, unë dëshiroj të qartësoj për të gjithë deputetët dhe theksoj se amendamenti 5 i cili e propozon ndryshimin e nenit 4 të Ligjit dhe ka të bëjë me përbërjen e këshillit të fshatit, nuk duhet të votohet sepse bie në kundërshtim të plotë me pakon e Ahtisarit. Faleminderit!

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Jo, Qeveria e ka tërhequr, veç propozimi i parë ka mbet. E tash e votojmë amendamentin 5 të propozuar nga Komisioni funksional.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe e votojmë tash amendamentin 5 të Komisionit funksional.

Me 42 vota për, 52 kundër dhe 6 abstenime, nuk miratohet amendamenti 5.

Tash e kemi propozimin e deputetit Hydajet Hyseni. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Me 1 votë për, 57 kundër dhe 10 abstenime, nuk miratohet as amendamenti 5 i deputetit Hydajet Hyseni.

Vazhdojmë me amendamentin 6, që i ka tri propozime:

- Propozimi i Komisionit funksional,
- Propozimi i Qeverisë, dhe
- Propozimi i deputetit Hydajet Hyseni, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Deputet, e ke fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit! Druaj që kur ta them se është edhe ky propozim i imi në përputhje me tjerët, pastaj deputetët do ta kundërshtojnë se dikush i ka shkruar – jo.

Është kërkuar vetëm që të hiqen shprehjet “zbatojnë” ose “integrojnë”, sepse është prejudikuar se është non-sens - ato shqyrtojnë se a e zbatojnë a integrojnë, pastaj vendosin vetë institucionet. Dhe Komisioni është pajtuar, Qeveria është pajtuar. Aman, vetëm mos votoni në mënyrë të verbër se mendoj që po e zhvleftësojmë edhe këtë Kuvend dhe vetvete dhe po marrim përgjegjësi për do pasoja që do të jenë të pashmangshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Nëse jeni dakord, shkojmë menjëherë në votim, sepse votimi po vendos.

(Ndërhyrje)

Pra, e kemi amendamentin 6, është varianti i parë, i propozuar nga Komisioni funksional dhe votojmë tash:

Me 71 votë për, 4 kundër dhe 19 abstenime, miratohet amendamenti 6.

E kemi amendamentin 7, i Komisionit funksional dhe të Qeverisë, bashkë.

Votojmë tash:

Me 65 vota për, 10 kundër dhe 18 abstenime, miratohet amendamenti 7 i Komisionit funksional dhe i Qeverisë.

Në radhë është amendamenti 8, me dy propozime:

- Propozimi i parë është i Komisionit funksional dhe i Qeverisë, dhe
- Propozimi i dytë i deputetit Hydajet Hyseni.

Deputet, doni ta sqaroni amendamentin? Regjia, fjalën deputetit Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Po është kontestuar shprehja “palët mund t’i referojnë çështjes KZM-ës për shqyrtim” dhe është propozuar me amendament të zëvendësohet me “çështja mund të adresohet”. Qeveria është pajtuar me një variant “të përcillet në KZM”.

Po e tërheq vërejtjen sepse po votojmë sipas inercisë. Nëse mbetet qysh është, edhe në amendament e të referohet do të thotë krijohet raport absurd i institucioneve qendrore me një këshill të fshatit të cilit institucionet qendrore duhet t’i referojnë. Ky është pra propozimi im: të zëvendësohet me “adresojnë” ose “i përcjellin” qysh ka propozuar Qeveria. Faleminderit!

KRYETARI: Pasi po vendoset me votim, po votojmë propozimin e Komisionit funksional dhe të Qeverisë. Dhe votojmë tash:

(Reagim - polemikë)

Me 51 votë për, asnjë kundër dhe 18 abstenime, miratohet amendamenti 8.

(Reagim i L. Aliut...)

Tash e kemi amendamentin 9. Propozimi i Qeverisë, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

(Ndërhyrje)

Po, është çështje e juaj. Votat po vendosin!

(Polemikë - Ndërprerje e incizimit)

Pra, e kemi amendamentin 9. Propozim i Qeverisë, pa përkrahjen e Komisionit funksional. Qeveria a do ta arsyetojë propozimin e vet? Urdhëro!

MINISTRI DARDAN GASHI: Zoti kryetar, Qeveria tërhiqet nga amendamenti!

KRYETARI: Do të thotë, s'po e votojmë amendamentin 9.

Tash e votojmë amendamentin 10, që është i propozuar nga deputeti Hydajet Hyseni dhe Qeveria, i përkrahur nga Komisioni funksional. Meqë s'ka arsyetim, votojmë tash:

Me 63 vota për, 1 kundër dhe 22 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11, propozim i Qeverisë, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Ministër, amendamenti 11, propozim i Qeverisë pa përkrahjen e Komisionit funksional!

MINISTRI DARDAN GASHI: Zoti kryetar, Qeveria tërhiqet edhe nga ky amendament.

KRYETARI: E votojmë amendamentin 12. I kemi dy propozime:

- Propozimi i Komisionit funksional, dhe
- Propozimi i deputetit Hydajet Hyseni, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Deputet, a do ta arsyetosh amendamentin?

HYDAJET HYSENI: Po, është modifikuar dhe unë pajtohem me Komisionin.

KRYETARI: Mirë! Tash votojmë amendamentin 12, i propozuar nga Komisioni funksional dhe votojmë tash:

Me 65 vota për, 2 kundër dhe 19 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13. i propozuar nga Qeveria, me përkrahjen e Komisionit funksional, dhe votojmë tash:

Me 61 votë për, asnjë kundër dhe 24 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14, propozim i Qeverisë pa përkrahjen e Komisionit funksional.

(Ndërhyrje: Tërhiqet!)

Tërhiqet Qeveria! E votojmë tash amendamentin e fundit, 15 i Komisionit funksional dhe votojmë tash:

Prezentë janë 97 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten dhe votojmë tash.

(Ndërhyrje)

97 deputetë janë prezent në sallë!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Ju lutem, sepse pati ndërhyrje! Tash e votojmë, edhe një herë, amendamentin 15, sepse nuk e kemi deklaruar rezultatin e amendamentit 15.

Prandaj, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe tash e votojmë amendamentin 15.

Me 63 vota për, asnjë kundër dhe 26 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Dhe tash, e votojmë Ligjin në tërësi. Votojmë tash:

Me 59 vota për, 26 kundër dhe 7 abstenime, miratohet Ligji për fshatin Hoqë e Madhe.

Nëse jeni dakord, po vazhdojmë! Dhe, ju lus na kurseni pra gjatë diskutimit tuaj.

Tash e kemi pikën e pestë:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor, deputetin Nait Hasani, që para deputetëve të arsyetojë raportin, me rekomandime.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar! Ne kërkuam pushim, por Komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin për Qendrën Historike të Prizrenit, e ka bërë amendamentimin për të. Dhe edhe në këtë ligj, sikur në Ligjin e mëparshëm të fshatit Hoqë e Madhe kemi kundërshti në amendament për çka unë së pari them se në këtë ligj janë tri kundërshti. Është çështja e shkeljes së Kushtetutës dhe janë amendamentet që duhet të votohen.

Në këtë ligj Komisioni ka punuar dhe mund t'i falënderoj të gjithë se kanë punuar me vullnet për përmirësimin e këtij ligji, sepse Qendra Historike e Prizrenit ka nevojë ta ketë një ligj të mirëfilltë, jo në formën si ka ardhur, sepse po ta kishim lexuar në formën sikur ka ardhur e të ishte miratuar, kishte me qenë një terror për Qendrën Historike të Prizrenit.

Por, ndryshimet që janë bërë në këtë ligj dhe amendamentet që i ka prur Komisioni, e kanë përmirësuar thuaja në shumicën absolute të tij.

Shkelje të Kushtetutës kemi edhe në këtë ligj, në nenin 8, ku kërkohet që bashkësitë fetare të jenë pjesë e ligjit. Këtu duhet të deklarohet se a jemi shtet fetar apo jemi shtet laik.

Për këtë ligj, e falënderoj Ministrinë që e ka prurë, por në këtë formë ka gabuar kur e ka prurë sepse vërtet e shkelë Kushtetutën. Këtu nuk kemi të bëjmë me paketën e Ahtisarit, sepse në paketën e Ahtisarit nuk është paraparë që të ketë Prizreni Ligj – pra Qendra Historike, por është ardhur si ligj për nevojat e Qendrës Historike të Prizrenit.

Prandaj, nga deputetët kërkoj që amendamenti që ka të bëjë me këshillin – 11 të votohet amendamenti i komisionit, sepse është pikërisht në mbrojtje të Kushtetutës, në mbrojtje të Qendrës Historike të Prizrenit. Është në mbrojtje të shtetit laik, në mbrojtje të ardhmes sonë.

Mendoj se në këtë aspekt, duhet të themi se komisioni e ka pasur parasysh dhe është bërë publike edhe një memorandum i kishës serbe për Kosovën, që është i 2003-tës dhe drejtpërdrejtë shkon me shkeljen e Kushtetutës.

Prandaj, kërkoj që amendamentet e Komisionit funksional të miratohen sepse janë amendamente që e kanë përmirësuar dhe e përmirësojnë Ligjin dhe iu mundësojnë qytetarëve që atje të ndihen më mirë. Faleminderit!

(Drejtimitin e mbledhjes, e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në Raportin e Komisionit funksional.

Si duket, zoti Hyseni është paraqitur për fjalë!? A e keni kërkuar fjalën? Atëherë, zoti Hyseni e ka fjalën!

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Kam, pothuajse të njëjtin arsyetim. Do të mund të thosha shkurt – diksi. Po e përsëris, vetëm për të hequr çdo keqkuptim.

Kam qenë, jam dhe mbetem për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, madje edhe sikur ta kërkonin tjerët të kundërtën. Por, besoj shumë, se ky ligj do të ketë efekte kundërprodhuese, prandaj kam propozuar që konform dokumentit të Ahtisarit të ndryshohet titulli, të ndryshohet përmbajtja dhe do të evitoheshin të gjitha ato situatat që i patëm.

Unë mbetem megjithatë në këtë bindje, sado që jam realist dhe e di faktin se Kuvendi ka hyrë në këtë hulli, s'mund të kthehet prapa. Një fjalë e urtë e popullit thotë "Po të lidhin 100 vetë, zgjidhesh. Por, po u lidhe vet edhe një mijë vetë, nuk të zgjidhin dot"! Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Gërbeshi, e ka kërkuar fjalën.

EMIN GËRBESHI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë dhe deputete,

I nderuar kabinet qeveritar,

Unë edhe një herë do të shpreh shqetësimet e mia rreth Ligjit për Prizrenin.

Mendoj se edhe ky ligj i tejkalon përmasat e pakos së Ahtisarit. Shkelë me dy këmbët Kushtetutën e Kosovës.

Është ligj antishqiptar, antihistorik, antinjerëzor. Madje na dërgon në kohën e mesjetës ku kisha ka qenë sunduese e gjithçkahit.

Unë edhe një herë, për mos ta zgjatë, iu bëjë thirrje të gjithë deputetëve të Parlamentit - të mos ta votojnë këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1. Është i propozuar nga deputeti Hydajet Hyseni përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë, tani:

Me 3 vota për, 13 abstenime dhe 53 kundër, nuk miratohet.

Amendamenti 2. Janë dy propozime:

- Propozimi i Komisionit funksional, dhe
- Propozimi nga deputeti Hydajet Hyseni, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Atëherë e votojmë amendamentin 2, të Komisionit funksional.

Votojmë, tani:

Me 53 vota për, 15 abstenime dhe 1 kundër, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë, tani.

Me 55 vota për, 20 abstenime dhe asnjë kundër, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4 i ka dy propozime:

- Komisioni funksional dhe,
- Propozimi i deputetit Hydajet Haseni, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Sipas Rregullores, i pari është Komisioni funksional dhe votojmë tash:

Me 56 vota për, 20 abstenime dhe asnjë kundër, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5, me tri propozime:

- Komisioni funksional,
- Propozimi nga Qeveria, pa përkrahjen e Komisionit funksional dhe
- propozimi i deputetit Hydajet Hyseni pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Fjalën e ka kërkuar, zoti Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Ky amendament, si edhe dy amendamentet e mëparshme janë përfshirë dhe janë inkorporuar në propozimin e Komisionit, prandaj nuk mund të konsiderohen pa përkrahje. Kaq.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Tërhiqet propozimi i zotit Hyseni. Qeveria a ka diçka?

(Ndërhyrje: Tërhiqet!)

Edhe Qeveria tërhiqet! Atëherë e votojmë propozimin e Komisionit funksional dhe votojmë, tani.

Me 55 vota për, 17 abstenime dhe asnjë kundër, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë, tani.

Me 56 vota për, 18 abstenime dhe asnjë kundër, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7, i ka tri propozime:

- Komisioni funksional,

- Qeveria, dhe

- Hydajet Hyseni.

E dëshiron dikush për sqarim fjalën, apo dëshiron dikush të tërhiqet apo të gjithë të qëndrojnë.

(Ndërhyrje)

Qeveria tërhiqet! Zoti Hyseni?

HYDAJET HYSENI: Jo nuk tërhiqem, sepse është e njëjta gjë dhe është amendament i përbashkët, që të mos ketë keqkuptime. Do të thotë, e përkrah!

KRYESUESI: Atëherë, e qesim në votim sipas Rregullores propozimin e Komisionit funksional, dhe e votojmë tani amendamentin 7, sipas propozimit të Komisionit funksional.

Me 56 vota për, 19 abstenime, asnjë kundër, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë, tani.

Me 56 vota për, 19 abstenime dhe asnjë kundër, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë, tani.

Me 56 vota për, 21 abstenime dhe asnjë kundër, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Votojmë, tani.

Me 56 vota për, 22 abstenime dhe asnjë kundër, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11, i ka dy propozime:

- Propozimi i deputetit Nait Hasani, me përkrahje të Komisionit funksional dhe,
- Propozimi i Hydajet Hysenit, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Fjalën e ka zoti Hasani.

NAIT HASANI: Ju faleminderit, nënkryetar!

Amendamentin 11, në përbërjen e Këshilli, ne si Komision, unë si propozues dhe me mbështetjen e Komisionit, është kërkuar që përfaqësuesit e bashkësive fetare të hiqen dhe të jetë një këshillë profesional.

Në amendament ne i kemi formuluar 6 anëtarë të trashëgimisë kulturore, arkeologjisë, arkitekturës, nga shoqëria civile në Prizren që kanë përvojë në ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Ky është amendamenti që ne kemi kërkuar të përbëhet dhe këta njerëz të jenë nga kjo fushë dhe, nëse do të kemi hoxhallarë, priftë e popë aty, ata nuk janë në gjendje ta mbrojnë këtë dhe kjo është shkelje e Kushtetutës.

Prandaj kërkoj nga deputetët ta votojnë amendamentin tim, të mbështetur nga Komisioni, i cili është edhe në mbrojtje të Kushtetutës, në mbrojtje të qytetit të Prizrenit, në mbrojtje edhe të atyre vlerave që i kemi me Ligjin për trashëgimi kulturore, edhe për ato zonat e veçanta, edhe për Kishën e Shën Gjergjit edhe për Xhaminë e Sinan Pashës, por edhe për Lidhjen e Prizrenit.

Pra, me këtë këshill mbrohen të gjitha këto, nuk cenohet e drejta e askujt. Për ndryshe shkelja e Kushtetutës është, dhe po shihet që është bërë në ligjin e mëparshëm dhe do të bëhet edhe tash, por jam i detyruar pikërisht për këtë nen ta drejtojmë në Gjykatë Kushtetuese, nëse votohet që të jenë pjesë e bashkësisë fetare aty, sepse është shkelje e Kushtetutës.

Me këtë e dëshmojmë pikërisht edhe memorandumin e kishës, edhe paragrafin ku thotë: “Të pranohet qëndrimi i popullit serb dhe kishës se askush nuk ka të drejtë të heqë dorë nga Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit si pjesë e patjetërsueshme e territorit të popullit serb, shtetit serb dhe kishës”.

Prandaj kërkoj që deputetët ta votojnë amendamentin tim dhe të Komisionit me mbështetje sepse është mbrojtje e vlerave dhe e Kushtetutës.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Gashi a e do fjalën, apo kryeministri? Për fjalë, u paraqit kryeministri!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Të nderuar deputetë,

Amendamenti 11/a i Komisionit funksional i cili propozon që të ndryshohet neni 16 që ka të bëjë me përbërjen e Këshillit për trashëgiminë kulturore të Prizrenit nuk duhet të votohet sepse deformohet thelbi i këtij ligji, ndërsa rekomandimet për votim janë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Hyseni, e ka kërkuar fjalën!

HYDAJET HYSENI: Amendamenti im, ka të bëjë përsëri me emërtimin e gabuar dhe në kundërshtim me dokumentin e Ahtisarit. E kam këtu referencën: Aneksi 5 - Trashëgimie kulturore dhe fetare, neni 1/1 thotë: “kisha ortodokse serbe e Kosovës”. Unë propozoj që edhe në këtë ligj, të thuhet: “Kisha ortodokse në Prizren”, “Kisha ortodokse serbe në Hoqë të Madhe” siç ishte përpara dhe kjo do të ishte në rregull.

Nuk e kundërshtoj amendamentin e Komisionit, por insistoј në atë që të kihet kujdes se duke i dhënë pushtet përfaqësuesve të fesë dhe vetë kishës, më shumë se që ka në vetë Serbinë, ne po krijojmë një preseden që nuk i duhet askujt. Më së paku i duhet kishës ortodokse serbe dhe komuniteti serb.

Në Serbi po ashtu shteti është laik. Në Serbi kisha është e ndarë nga shteti dhe në Serbi bashkësitë fetare janë të barabarta. Pse duhet Kosova të shkojë përtej kësaj? Për t’i pëlqyer dikujt dhe për t’i bërë qefin?!

Unë, prandaj do të propozoja që të miratohet propozimi i Komisionit dhe, nëse mbetet emërtimi, emërtimi të caktohet në përputhje me dokumentin e presidentit Ahtisari. E theksoj, aneksi 5, neni 1, paragrafi 1.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Të shkojmë në votim. U dëgjuan arsyetimet e të tri palëve për amendamentin e 11.

Tash e votojmë Amendamenti 11 - propozim i deputetit Nait Hasani, pa përkrahje nga Komisioni funksional.

(Reagim: Me përkrahje!)

A me përkrahje? Mirë, me përkrahje. Më falni. Votojmë tani:

(Reagim)

Është kryer? OK!

(Reagim – ndërhyrje)

Jo, jo nuk është kryer. Mirë. Si duket ose nuk kanë dashtë me votuar. Kur është kryer? Po ende pa e qitë në votim, u krye, a?

(Ndërhyrje)

OK. Votojmë edhe një herë, atëherë është gabim i imi. Më falni. Nuk e kam parë.

Pra, e votojmë tash propozimin, me përkrahjen e Komisionit funksional.
Me 51 vota kundër, 6 abstenime dhe 27, nuk miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12

Votojmë, tani.

Me 57 vota për, 13 abstenime dhe asnjë kundër, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13

Votojmë, tani.

Me 56 vota për, 22 abstenime dhe asnjë kundër, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14. Propozim i Qeverisë, me përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë, tani.

Me 57 vota për, 27 abstenime dhe asnjë kundër, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15. I kemi dy propozime:

- Propozimin e Qeverisë, me përkrahje të Komisionit funksional dhe,
- Propozimi i deputetit Hydajet Hyseni, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

E hedhim në votim propozimin e Qeverisë, me përkrahjen e Komisionit funksional si të parin. Votojmë, tani.

Me 56 vota për, 24 abstenime dhe 1 kundër, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16, me propozim i Qeverisë, me përkrahje të Komisionit funksional.

Votojmë, tani.

Me 57 vota për, 23 abstenime dhe asnjë kundër, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17, me propozim i Qeverisë pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë, tani.

(Ndërhyrje: Tërhiqet!)

Atëherë tërhiqet. Në rregull. Tërhiqet Qeveria nga amendamenti i 17.

Amendamenti 18

Votojmë, tani.

Me 59 vota për, 22 abstenime dhe asnjë kundër, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19

Votojmë, tani.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Me 58 vota për, 22 abstenime dhe 1 kundër, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20, i ka dy propozime:

- Propozimi i Komisionit funksional dhe,
- Propozimi i deputetit Hydajet Hyseni, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë tani.

Me 58 vota për, 22 abstenime dhe 1 kundër, miratohet amendamenti 20, propozimi i Komisionit funksional.

Amendamenti 21. Propozim i deputetit Nait Hasani, me përkrahje nga Komisioni funksional.

Janë paraqitur për fjalë Hydajet Hyseni, Nait Hasani. Cili po e doni fjalën? Naiti, si propozues, një herë. Urdhëroni!

NAIT HASANI: Ju faleminderit, nënkryetar!

Kam kërkuar që me këtë amendament, shkolla e popëve në Prizren, e cila shkollë ka edukuar popë e politikanë që kanë bërë gjenocid, krim kundër njerëzimit, siç është Millosheviqi, dhe të tjerë, që kjo shkollë derisa është funksionale dhe është në territorin e Kosovës dhe në Prizren, të mos të jetë shkollë që do të prodhojë popë për Serbinë, sepse kjo është shkollë që ka qenë në kohën e ish-Jugosllavisë, që ka prodhuar popë dhe ata popë e kanë bekuar për krime Millosheviqin.

Për këtë, kemi dëshmi të mjaftueshme. E kemi bekimin e peshkopit që ia ka dhënë Millosheviqit për krime dhe mbështetjen.

Prandaj, kërkoj që deputetët ta votojnë amendamentin, që kjo shkollë të mos jetë pjesë e aneksit, por të jetë jashtë mbrojtjes si shkollë ose si objekt i trashëgimisë.

Nëse kjo hynë si objekt aty brenda në listë, atëherë do të ketë një ndjenjë shumë të urrejtjes, një ndjenjë të krimit, sepse prej kësaj shkolle kanë dalë të gjithë ata që na kanë luftuar, na kanë poshtëruar, na kanë fyer dhe na kanë dënuar.

Nga kjo shkollë kanë dalë edhe të gjithë UDB-bashët e Serbisë që kanë punuar në Kosovë, që kanë torturuar, prej Rexhep Malës, Nuhi Berishës dhe Afrim Zhitisë, Fahri Fazliut, po edhe Fadil Vatën.

Nga kjo shkollë kanë dalë të gjithë ata, e ne sot ta shpallim, është një ndjenjë... Unë nuk dua të them që këtu të bëjë një patriotizëm, por këtu e vlerësojmë një gjendje reale që një shkollë le të mbetet shkollë, por mos të jetë pjesë e zonës së mbrojtur, le të mbetet si objekt ose nëse do të jetë shkollë le të jetë pjesë shkolle që do të shkojnë në shkollë ata, por jo popë e priftë për Serbinë.

Prandaj, edhe një herë kërkoj që deputetët ta votojnë amendamentin, sepse janë në shërbim të qytetit të Prizrenit dhe largimit nga kjo e keqe, nga ky tmerr, nga ky terror që e ka prodhuar kjo shkollë.

KRYESUESI: Hydajet Hyseni!

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë kam kërkuar fjalë edhe përpara për ta përsëritur atë sqarimin dhe le të jetë edhe si vërejtje për Administratën.

Nëse bëjmë një amendament të deputetit dhe bartet në Komision, dhe Komisioni e merr pastaj e inkorporon në amendamentet e veta, nuk mund të dalë pa përkrahje. Sepse, atëherë cili do të ishte sensi i prezantimit të amendamenteve. Le të jetë atëherë amendament i Komisionit dhe i deputetit.

Dhe e dyta. Do të duhej, megjithatë amendamentet, sidomos kur janë saktësime që nuk e kundërshtojnë amendamentin, të votohen.

Përndryshe, cili do të jetë motivimi i deputetëve për t'u angazhuar. Megjithatë, nuk është punë e këndshme dhe nuk është e leverdishme kjo për ta bërë.

KRYESUESI: Unë jam dakord! Praktikat janë të tilla prej fillimit, nuk mund t'i ndryshoj. Deputeti Marinković e ka kërkuar fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala gospodine predsedavajući!

Hteo sam samo ukratko da kažem gospodinu Naitu da su iz škole u Prizrenu, gde kako on kaže „školuju se popovi“, iz tih škola su izašli pravi sveštenici koji pripovedaju ljubav, zajedništvo i sve ostalo. Ne propovedaju ni mržnju, ni bilo šta drugo. Gospodine, Nait! Vi ne znate o čemu govorite!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti Kryeministër, e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Vetëm desha, i nderuari zoti nënkryetar, të qartësoj përsëri pozicionin e Qeverisë dhe qëndrimin e Qeverisë, pra për amendamentin 21. Ky amendament nuk duhet të votohet. Ju faleminderit shumë! Pra, nuk duhet të votohet!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

(Ndërhyrje)

Po e ke thënë, e ke thonë krejt çka ke pas, mendoj, por merre. Fol, fol Nait. Urdhëroni! Zoti Hasani, kryetari i Komisionit, e ka fjalën!

NAIT HASANI: Po, ju lutem! Kjo ishte për me i ndihmuar kolegut, kryetarit të Komisionit për komunitete se, kur vetë Mirko Gjergjeviqi, i cili në vitin 1998 e ka thënë që kisha, në periudhën e kaluar të diktaturës së Millosheviqit, nuk ka qenë vetëm dëshmitare, por edhe pjesëmarrës në të gjitha punët.

Kjo nuk guxon të harrohet. Në disa momente të krizës, kur shihet se Millosheviqi po dështon politikisht, kisha i dha përkrahje vendimtare, bile edhe partriarhu Pavle me 1995 ia ka dhënë Millosheviqit nënshkrimin e tij blanko për me bë krime në të gjitha anët.

KRYESUESI: Atëherë i dëgjuat prononcimet për e kundër - prononcimin Qeverisë. Votojmë, tani amendamentin 21, do të thotë propozimin e Naitit, me përkrahjen nga Komisioni funksional që Qeveria po kërkon të mos votohet. Votojmë, tani:

(Ndërhyrje)

Jo, jo, votojmë tani. Unë nuk e kam dhënë sinjalin. Mirë!

Me 49, paskeni votuar....!

(Ndërhyrje)

ISMET BAEQIRI: Ju faleminderit, zotni nënkryetar!

Derisa ju e përfundoni, e po shpreheni këtu po ecin sekondat dhe ne po votojmë dhe në fund po thoni - 2 sekonda, 3 - votojmë, tash. Prandaj, thuane, ose regjia mos të ngutet për këtë që e thatë tash, sepse këtu është problemi.

KRYESUESI: Në rregull. Regjia e dinë, sepse deri sot njësoj është votuar. Unë nuk e kam dhënë sinjalin me u votuar.

(Ndërhyrje)

Votojmë amendamentin 21, dhe votojmë tani:

(Ndërhyrje: Cili është?)

Me 46 vota kundër, 6 abstenime dhe 24 vota për, nuk miratohet.

Amendamenti 22. Propozim i Qeverisë, me përkrahje të Komisionit funksional Votojmë, tani.

Me 59 vota për, 23 abstenime dhe asnjë kundër, miratohet amendamenti 22.

Tash, e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

(Ndërhyrje)

Për çka? U krye amendamenti, Sabri! Po e votojmë ligjin tani.

(Reagim)

Zoti Hamiti e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Zotni, kolegë i nderuar Haliti!

Po shihet që ligji kalon, dhe votat po shihen. Nuk ka nevojë n'hunë e n'buzë me e bërë këtë votim, se nuk na ka hije, nuk ka arsye! Nën një.

Nën dy. Me të gjitha rregulloret që i ke ti përpara, dhe me sekretarin, a me dy sekretarë që i ke pranë ta shpjegojnë se për votën kundër për çkadoqoftë, ka të drejtë të kërkohet dhe të deklarohet. Dhe unë, kam të drejtë të kërkoj qoftë edhe si deputet, e le më si përfaqësues i një partie politike, të deklaroj pse është vota kundër. Dhe, për këtë e kërkoj unë fjalën. Ti s'po ma jep!

Tash, të lutem, meqë dola po e them: LDK-ja ka votuar kundër dy ligjeve, që i kishim sot, edhe të Ligjit për Hoqën, edhe për Qendrën Historike të Prizrenit. Pse? Sepse këto ligje janë hartuar duke u deklaruar që bëhen për të çuar në vend një provizion të pakos së Ahtisarit - që është obligim në Kushtetutën e Kosovës! Nuk është, se ai provizion kërkon zgjidhje ligjore, jo ligje të veçanta.

E dyta. Këto dy ligje të veçanta, ndonëse janë hartuar që të merren në mbrojtjen ose trajtimin historik të kulturave, po them në shumës, në të vërtetë e kanë mungesën - behanen më të keqe të mundshme, sepse: kisha ortodokse, e cila edhe ashtu në tronditje të mëdha politike në Kosovë, ka qenë bërë qendër politike, në këtë rast me ligj, me rregull, me normë e bëjnë edhe qendër pushtetore. Prandaj ne edhe kemi votuar kundër. Ju faleminderit, zotni!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Shpresoj që tani do të votoni kundër!

(Ndërhyrje)

Tash, e votojmë Ligjin në tërësi. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani.

Me 56 vota për, 30 kundër dhe 4 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit.

A e do fjalën? Zoti Kryeministër, e ka kërkuar fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë vetëm desha të sqaroj para pushimit që po kërkohet prej deputetëve.

(Reagim)

Po, mirë vazhdojmë! Qeveria është e gatshme me vazhduar deri në fund, por dëshiroj të theksoj se edhe Ligji për Prizrenin, edhe Ligji i Hoqës së Madhe është votuar në momentin që është votuar dokumenti i presidentit Ahtisari prej Lidhjes Demokratike, Partisë Demokratike, AKR-së dhe AAK-së. Ju faleminderit shumë, zoti Hamiti!

KRYESUESI: Vazhdojmë, dhe nuk ka me dal jashtë, kush do me e kryer seancën. Pra, vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryeartin e Komisionit funksional, zotin Pajaziti, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Kryeministër,

Deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në pajtim me nenet 57, 67 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me datën 13. 04. 2012, e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe ka vendosur që Kuvendit t'ia paraqes raportin lidhur me këtë Projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike.

Andaj i ftojme grupet parlamentare dhe të gjithë deputetët që t'i votojnë amendamentet dhe Ligjin në tërësi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Atëherë vazhdojë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 2

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka miratohet

Amendamenti 3

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka miratohet.

Amendamenti 4

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka miratohet.

Amendamenti 5

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka miratohet.

Amendamenti 6

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka miratohet.

Amendamenti 7

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka miratohet.

Amendamenti 8

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka miratohet.

Tani e votojmë tekstin në tërësi. Në sallë janë 66 deputetë.

Votojmë tani:

Konstatohet se me 69 vota për, 3 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrje publike.

Pika e shtatë e rendit të ditës, është:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetaren e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, deputeten Hadergjonaj, që para deputetëve ta arsyetoj Raportin me rekomandime.

Nuk e do fjalën! Atëherë, fillojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 2

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 3

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 4

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, miratohet.

Tani e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë, tani.

Në sallë janë 75 deputetë.

Me 67 vota për, 4 abstenime dhe 1 kundër, Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin e plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme.

Të nderuar deputetë,

Ju faleminderit për bashkëpunimin! Mirë u pafshim në seancën e ardhshme!

E përgatiti: Njësia për transkriptim dhe lekturë